

PROSPEKT

ABI FLEX USD
2021

abinvest

INFORMACION I RËNDËSISHËM MBI FONDIN E INVESTIMIT DHE PROSPEKTIN E FONDIT

Fondi i Investimit ABI FLEX USD është një sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, e themeluar nga ABI Invest sh.a. (në vijim: Shoqëria Administruese), shoqëri administruese e licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim: 'AMF'), për të administruar sipërmarrje të investimeve kolektive. Shoqëria administruese e zhvillon aktivitetin e saj me ndershmëri dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të investitorëve.

Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, ose fondi i investimit është një grupim i veçantë aktivesh, pa personalitet juridik, i krijuar në bazë të një marrëdhënieje kontraktuale, pas licensimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dhe i administruar nga shoqëria administruese, me qëllim grumbullimin e aktiveve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave të fondit.

Shoqëria administruese është subjekti juridik qeverisës i fondit të investimit, që e administron dhe e përfaqëson atë në lidhje me palët e treta.

Aktivitetet e fondit investohen në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut dhe dispozitave të ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Mbajtësit e kuotave kanë të drejtën jo vetëm të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, por edhe të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave që zotërojnë.

Prospekti përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që investitorët potencialë të jenë në gjendje të vlerësojnë objektivat dhe strategjitë kryesore të Fondit të Investimit ABI FLEX USD (në vijim: Fondi), risqet specifike të lidhura me investimin në fond, profilin e investitorëve të përshtatshëm, si dhe tarifat dhe pagesat e Fondit.

Shoqëria administruese konfirmon që ky Prospekt përmban të gjithë informacionin e konsideruar thelbësor në kontekstin e objektivit të investimit dhe deklaron që ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm që informacioni që përmban ky Prospekt, të jetë në përputhje me faktet, dhe që nuk ka përjashtime faktesh që mund të ndikojnë mbi domethënien e tij.

Informacioni i dhënë në këtë Prospekt është shprehur ndershmërisht, për të orientuar investitorët. Çdo opinion ose parashikim i përmendur nuk ka për qëllim keqinformimin e investitorit. Janë kryer të gjitha kërkimet e duhura për të konstatuar dhe verifikuar për sa me sipër.

Prospekti nuk përbën një ftesë për të blerë kuota të Fondit por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat dhe risqet e lidhura me pjesëmarrjen në Fond.

Investitorët potencialë këshillohen të lexojnë këtë Prospekt në mënyrë që të kenë një informacion të qartë mbi karakteristikat dhe risqet e fondit përpara se të marrin vendimin për të investuar.

Contents

PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORË	5
1. SHOQËRIA ADMINISTRUESE	9
1.1 Kuadri ligjor i shoqërisë	9
1.2 Fondët nën administrim	9
1.3 Organet drejtuese të shoqërisë administruese	9
1.3.1 Asambleja e aksionarëve	9
1.3.2 Këshilli i administrimit	10
1.3.3 Administratori	11
1.3.4 Personeli kyc	11
1.4 Delegimi i funksioneve të shoqërisë administruese te palët e treta	11
1.5 Konflikti i interesit në lidhje me funksionet e deleguara	12
2. FONDI I INVESTIMIT	12
2.1 Fondi ABI FLEX USD – Sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike	12
2.2 Krijimi i fondit dhe kohëzgjatja	13
2.3 Qëllimi i investimit dhe politika e investimit	13
2.3.1 Qëllimi i investimit	13
2.3.2 Strategjia e investimit dhe shpërndarja e aktiveve	14
2.4 Faktorët e rrezikut	20
2.4.1 Risqet e lidhura me investimin	20
2.4.2 Risqet e lidhura me Shoqërinë Administruese	24
2.4.3 Risqet me impakt tek investitorët dhe shoqëria administruese	25
2.5 Shuma minimale e investimit dhe vlera e kuotës	25
2.6 TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT	26
2.7 BLERJA DHE SHLYERJA E KUOTAVE	27
2.7.1 BLERJA E KUOTAVE NË FOND	27
2.7.2 Shlyerja e kuotave	28
2.8 Këmbimi i kuotave	28
2.9 Transferimi i kuotave të fondit	29
2.10 Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave në një fond investimi	29
2.11 Administrimi i pjesës së fitimit për mbajtësit e kuotave	30
2.12 Vlerësimi i aktiveve dhe cmimit të kuotës	30
2.13 Detyrimi i informimit të investitorëve	31
2.14 Procesi i mbylljes së fondit	32
2.14.1 Në cilat rrethana kryhet mbyllja	32

2.14.2 Ekzekutuesi i procesit të mbylljes së Fondit	32
2.14.3 Likuidimi dhe afatet për mbyllje të Fondit	32
2.15 Tarifat dhe Komisionet.....	33
2.16 Trajtimi fiskal.....	34
2.17 Viti Financiar	34
3. DEPOZITARI.....	35
3.2 Konflikti i Interesit në lidhje me depozitarin	36
3.3 Përshkrimi i funksioneve të deleguara nga depozitari në lidhje me kujdestarinë e instrumentave financiare në monedhë të huaj.....	36
4. INFORMACION PLOTËSUES	37
4.1 Konflikti i interesit	37
4.1.1 Transaksionet me shoqërinë mëmë “Banka Amerikane e Investimeve”	37
4.1.2. Depozitat me Bankën Amerikane të Investimeve.....	37
4.1.3 Disa anëtarë të këshillit të administrimit mbajnë pozicione drejtuese në shoqërinë mëmë “Banka Amerikane e Investimeve”	38
4.2 Kujdesi	38
4.3 “FATCA” dhe “CRS/Shkëmbimi Automatik i Informacionit të llogarive financiare”.....	38
4.4 ANKESAT	38
4.5 Ekzekutimi më i mirë i vendimeve të tregtimit	39
4.6 Vendet e ekzekutimit.....	39
4.7 Profili i investitorit tipik të cilit i drejtohet fondi.....	39
ANEKSI 2: DEKLARATA E KUJDESTARISË	44
ANEKSI 3: DEKLARATA E INVESTITORIT	45

PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORË

Për qëllimet e këtij Prospekti, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

AMF: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Aksione: Tituj të transferueshëm që përfaqësojnë një pjesë të pronësisë së investitorit në një shoqëri tregtare, me pritshmëri marrjen e një pjese të fitimeve në formën e dividendëve, ose të përfitimit nga rritja e çmimit të aksioneve të saj, ose të dyja.

Aktive: tituj, instrumente të tregut të parasë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të sipërmarrjes së investimeve kolektive

Depozitari: bankë e licensuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ofruar shërbime depozitimi për sipërmarrjet e investimeve kolektive

Diversifikimi i portofolit: investim i aktiveve të Fondit në instrumente të ndryshëm financiare, në mënyrë që të zvogëlohet risku nga investimi

FATCA: ligj federal i SHBA, i cili u kërkon të gjithë institucioneve financiare të huaja t'i raportojnë Agjencisë së të Ardhurave në SHBA (IRS) informacionin mbi llogaritë financiare të taksapaguesve amerikanë, ose të entiteteve të huaja në të cilat taksapaguesit amerikanë zotërojnë një përqindje të rëndësishme

Fond investimi: sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar si fond kontraktor, me objekt të vetëm sigurimin e kapitalit nga investitorët dhe investimin e këtij kapitali në lloje të ndryshme investimesh, sipas një politike të miratuar për investimet, me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit të investimeve.

Fond i tregtuar në bursë (ETF): sipërmarrja e investimeve kolektive që ndjek një indeks, sipas të cilit tregtohet gjatë gjithë ditës, një klasë kuotash ose aksionesh në një platformë tregtimi dhe me një krijues tregu, i cili garanton që çmimi i kuotave ose aksioneve të tij në treg nuk ndryshon ndjeshëm nga vlera neto e aktiveve dhe, sipas rastit, nga vlera neto orientuese e aktiveve. Fondi i tregtuar në bursë ngjason me sipërmarrjen e investimeve kolektive (SIK), megjithatë, në ndryshim nga SIK është i listuar në bursë dhe tregtohet gjatë gjithë ditës ashtu si aksionet e zakonshme dhe çmimi i tij luhet gjatë ditës.

Instrument derivativ: një instrument financiar, vlera e të cilit mbështetet ose rrjedh nga një aktiv tjetër bazë ose grup aktivesh të tjerë. Aktivet kryesore më të zakonshme për instrumentat derivative janë aksionet, obligacionet, monedhat, normat e interesit dhe indekset e tregut.

Instrument i të ardhurave fikse: instrument financiar që paguan tek investitorët pagesa të interesit fikse deri në datën e maturimit. Në maturim, investitorët marrin shumën e principalit që kishin investuar. Obligacionet qeveritare dhe të korporatave janë llojet më të zakonshme të produkteve me të ardhura fikse. Sidoqoftë, ka fonde të tregtuara në bursë (ETF) dhe sipërmarrje të investimeve kolektive (SIK), të cilat investojnë në produkte me të ardhura fikse.

Investitor: subjekti që ka në pronësi kuota në një fond investimi

Këshilli i Administrimit: duke iu referuar ligjit për shoqëritë tregtare, është i vetmi organ administrimi i shoqërisë aksionare, i cili ushtron njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje (sistemi me një nivel)

Kthimi nga investimi: fitimi që merret nga investimi i aktiveve

Kohëzgjatja: tregues i ndjeshmërisë së çmimit të një obligacioni (që përfshin interesin e përlllogaritur) ndaj ndryshimeve në normat e interesit

Kohëzgjatja e portofolit: maturiteti mesatar i ponderuar i obligacioneve individuale që përbëjnë portofolin e investimeve

Kuotë: çdo pjesëmarrje e barabartë përpjesëtimore, që rezulton pas pjesëtimit të interesave përfituese në aktivet, objekt i sipërmarrjes së investimeve kolektive të fondit të investimeve.

Kuota akumulimi: kuotat e një fondi për të cilin të ardhurat nga investimi riinvestohen automatikisht dhe përfitimet për investitorët vijnë nga akumulimi i vlerës së atyre kuotave

Manaxher i Fondit: personi përgjegjës në shoqërinë administruese për administrimin e portofolit të investimit

Marrëveshje e riblerjes (Repo): është ajo lloj marrëveshje ku shitësi i letrave me vlerë, pranon t'i blejë ato përsëri në një kohë dhe me çmim të paracaktuar

Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo): blerja e letrave me vlerë për t'i rishitur ato më pas në një datë të caktuar me një çmim më të lartë

Ofertë publike: ftesa për të nënshkruar tituj, e cila i drejtohet një numri të papërcaktuar personash, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv

Periudha minimale e investimit: periudha e investimit fillon në momentin e blerjes së kuotave të fondit, dhe zgjat deri në momentin e mbërritjes në ABI Invest të një kërkesë të vlefshme për shitjen e kuotave.

Portofol Investimi: tërësia e investimeve të kryera me aktivet e fondit

Prospekt: dokumenti i bërë publik, që përmban informacionin më të rëndësishëm për sipërmarrjen e investimeve kolektive, si politika e investimit, politika e administrimit të riskut, tarifat etj.

ABI INVEST: Shoqëria administruese e Fondit ABI FLEX USD

Rregullat e Fondit: dokumenti kryesor që rregullon marrëdhënien ligjore midis Shoqërisë Administruese dhe mbajtësve të kuotave në Fond

Sipërmarrje e investimeve kolektive (SIK): është çdo formë organizimi lidhur me çdolloj pasurie, përfshirë monetare, qëllimi i së cilës është mundësimi i personave që marrin pjesë në këtë formë organizimi (“pjesëmarrësit”), të bëhen pronarë të pasurisë ose të një pjese të saj, të përfitojnë fitime ose të ardhura që rrjedhin nga marrja, mbajtja, administrimi ose shitja e pasurive ose shumave të paguara nga këto fitime ose të ardhura dhe që ka karakteristikat e përcaktuara në ligjin 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

Sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur: sipërmarrja e cila në bazë të dokumentit themelues shlyen pjesëmarrjet çdo ditë pune, sipas një çmimi të llogaritur në bazë të vlerës neto të aktiveve për pjesëmarrje të sipërmarrjes, të përcaktuar në përputhje me ligjin.

“Sipërmarrje e veçantë”: sipërmarrja e investimeve kolektive që nuk është sipërmarrje ombrellë ose nënfond.

Standardi i Përbashket i Raportimit (CRS): përbën një kërkesë rregullatore për raportim për Institucionet Financiare të vendosura në juridiksionet pjesëmarrëse dhe ka qëllimin për të shmangur evazionin fiskal.

Shkëmbimi automatik i informacionit për llogaritë financiare (AEIFA): Ligji nr.4, miratuar nga Kuvendi i RSH në 30/01/2020

Shoqëria administruese: shoqëri aksionare e themeluar në përputhje me ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare dhe e licensuar nga AMF, për të administruar fonde pensioni dhe/ose sipërmarrje të investimeve kolektive bazuar në ligjin për SIK

Titull: instrument financiar i negociueshëm që emetohet dhe tregtohet për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tij. Mund të jetë titull i pjesëmarrjes në kapital, titull borxhi, aksion dhe kuota të fondit të investimeve ose fondit të pensioneve

Titull borxhi “Me gradë investimi”: titull me një vlerësim të cilësisë së kredisë të paktën Baa3 nga Moody’s ose vlerësime ekuivalente të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht. Këto tituj përfaqësojnë një risk relativisht të ulët të paftësisë paguese.

Titull borxhi “Nën gradë investimi”: titull me një vlerësim të cilësisë së kredisë nën Baa3 nga Moody’s ose vlerësime ekuivalente të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht. Këto tituj paguajnë norma më të larta interesi sepse kanë vlerësim më të ulët të cilësisë së kredisë sesa titujt “Me gradë investimi”.

Treg i rregulluar: sistemi shumëpalësh që shfrytëzohet dhe/ose administrohet nga një subjekt operator tregu, i cili bashkon ose ndihmon në bashkimin e interesave të shumta të shitblerjes që kanë të tretët për instrumente financiare, në përputhje me rregulloret e detyrueshme të tij. Instrumentet financiare pranohen për tregtim sipas rregulloreve dhe/ose sistemeve të tregut të rregulluar dhe ai licensohet, regjistrohet ose njihet nga autoriteti. Ky përkufizim përfshin gjithashtu tregjet mbi banak, ku titujt janë emetuar dhe garantuar nga qeveria

e Republikës së Shqipërisë me kusht që shitja të njihet dhe të rregullohet nga autoriteti, si dhe të jetë e hapur ndaj publikut.

Tregu i aksioneve: është një treg në të cilin emëtohen dhe tregtohen aksione, i cili mund të jetë një treg i rregulluar, apo një treg mbi banak (OTC).

Tregu i parasë: Tregu i parasë i referohet tregtimit në instrumente borxhi afatshkurtra.

Vlera neto e aktiveve: vlera e agreguar e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive në momentin e llogaritjes.

Vlera neto e aktiveve për kuotë: vlera neto e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, e pjesëtuar me numrin e kuotave në emetim në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve.

Vlerësim i titujve të borxhit: Vlerësimi apo renditja e titujve, e kryer nga agjensitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të riskut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi. Sipas agjensisë Moody's, titujt e borxhit afatgjatë të klasifikuar në intervalet Aaa deri Baa3 (tituj me gradë investimi) përfaqësojnë risk më të ulët e për rrjedhojë pritshmëria për kthimin nga investimi është më e ulët. Titujt e borxhit të klasifikuar në intervalet Ba1 deri C (tituj me nën gradë investimi) përfaqësojnë risk të lartë, për rrjedhojë kanë kthimin e pritshëm nga investimi më të lartë.

1. SHOQËRIA ADMINISTRUESE

1.1 Kuadri ligjor i shoqërisë

ABI INVEST – Shoqëria administruese e SIK, është një shoqëri aksionare, me seli në Rrugën e Kavajës 27/1, Tiranë, Shqipëri. Aksionari i vetëm i shoqërisë është Banka Amerikane e Investimeve Sha., e cila zotëron 100% të aksioneve. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 45,000,000 (dyzet e pesë milionë) lekë.

ABI Invest mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe Ligjit nr. 56/2020 dt 30.04.2020, “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. ABI Invest ka si objekt të aktivitetit të saj:

- Veprimtarinë e administrimit të aktiveve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, mbështetur në licencën me nr. 6, datë 27.02.2020, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria administruese, vepron në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhshmëri me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarive të saj. Përdor aftësitë dhe dijet e nevojshme, vepron me korrektësi dhe me kujdesin e duhur. Ajo përdor me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtaritë e saj në mënyrë të shëndoshë. Gjithashtu, shmang konfliktet e interesit në mënyrë që të garantojë që interesat e investitorëve në çdo lloj sipërmarrjeje të investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e administrimit të fondeve të kenë përparësi dhe të qëndrojnë mbi interesat e aksionarëve të shoqërisë administruese të fondeve, interesat e tyre dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të.

1.2 Fondët nën administrim

ABI INVEST sh.a. administron

1. Fondin e investimit “ABI EIA” me KOD [FI – B7]
2. Fondin e investimit “ABI FLEX USD”
3. Fondin e investimit “ABI FLEX EURO”

1.3 Organet drejtuese të shoqërisë administruese

Organet drejtuese të shoqërisë administruese janë: Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit, dhe Administratorët.

1.3.1 Asambleja e aksionarëve

Eshtë e kompozuar nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarit të vetëm të shoqërisë – Banka Amerikane e Investimeve Sha

1.3.2 Këshilli i administrimit

Është organi qëndror i shoqërisë administruese, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese. Ky organ do të kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjet në fuqi, standardet e kontabilitetit dhe financiare, miraton politikat financiare, të investimit, prospektin, etj.

Këshilli i administrimit ka në përbërje katër anëtarë si më poshtë:

Z. Armand Muharremi: Kryetar i Këshillit të Administrimit

Z. Muharremi, aktualisht në pozicionin e Drejtorit të Divizionit të Financës së Bankës Amerikane të Investimeve ka një eksperiencë të gjerë në sektorin bankar, të taksave dhe të auditit. Z. Muharremi filloi karrierën e tij me KPMG Shqipëri si auditor, dhe shumë shpejt u promovua si Supervisor i Auditit. Ai vazhdoi karrierën e tij në Auditim në bankën “Societe Generale”, Shqipëri në vitin 2004 në pozicionin e Drejtuesit të Kontrollit të Brendshëm dhe më vonë e Drejtuesit të Divizionit të Financës. Z. Muharremi vijoi karrierën e tij në Audit dhe Financë me Ernst & Young (2009 – 2011) dhe me “Crédit Agricole”, Shqipëri që prej vitit 2011 si Drejtor i Divizionit të Financës. Eksperienca e tij e gjatë në sistemin bankar në Shqipëri është një avantazh i madh për Grupin Financiar ABI. Z. Muharremi është diplomuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë në degën “Menaxhim Biznesi” në vitin 1998.

Zj. Teuta Çinari: Zv-Kryetare e Këshillit të Administrimit

Znj. Çinari, aktualisht mban pozicionin e Drejtores së Departamentit të Thesarit pranë Bankës Amerikane të Investimeve. Ka një eksperiencë 20 vjeçare në sektorin Bankar, specifikisht në profilin e administrimit të produkteve të Thesarit e gjithashtu në hartimet dhe aplikimet e politikave të ndryshme të lidhura me profilin, si ajo e investimeve, likuiditetit, normave të interesit, vlerësimit të titujve etj.

Znj. Çinari është drejtuese/koordinuese në marrëdhëniet mes Bankës dhe Bankës së Shqipërisë në proceset e licencimeve apo zgjerimit të licencave të veprimtarive të fushës së Thesarit e më gjerë.

Znj. Çinari është licencuar nga AMF si Broker në Tituj dhe është Broker i autorizuar nga Bursa Shqiptare e Titujve.

Znj. Çinari është diplomuar në vitin 2001 nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë në degën “Ekonomiks - Statistikë e aplikuar”.

Zj. Brikena Hoxha: Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Hoxha ka eksperiencë të gjërë në të drejtën publike dhe private në SHBA ku ka punuar si avokate në studio ligjore prestigjioze për çështje gjyqësore në lidhje me instrumenta financiare, krimin ekonomik, kontrata dhe shoqëritë (2005 – 2009). Në Shqipëri e Kosovë ka punuar me organizata ndërkombëtare duke dhënë konsulencë në hartimin e legjislacionit ekonomik, të drejtën administrative, në çështje gjyqësore etj. Znj. Hoxha është e licensuar dhe pranuar avokate në Dhomën e Avokatisë së Shtetit të New York-ut, SHBA. Që prej Tetorit 2015, ajo punon si Drejtore e Departamentit Ligjor, në Divizionin Ligjor dhe të Përputhshmërisë të Bankës Amerikane të Investimeve SHA. Znj. Hoxha është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë në 2001 dhe zotëron një Master në Drejtësi (LL.M.) nga Universiteti i “Columbia”, Fakulteti i Drejtësisë, New York, SHBA (2003).

Z. Redi Hakani: Anëtar i Këshillit të Administrimit (anëtar ekzekutiv)

Z. Hakani mban pozicionin e Administratorit të Përgjithshëm në Shoqërinë Administruese të Sipërmarrjes së Investimeve Kolektive “ABI Invest”. Ka një eksperiencë 15 vjeçare në sektorin Bankar, fillimisht në Kontabilitet dhe më pas në profilin e Thesarit. Më së fundmi, Supervisor i Sektorit të Menaxhimit të Aktiv-Pasiveve në Bankën Amerikane të Investimeve Sha. Ndër detyrat e përgjegjësitë kryesore, vend të rëndësishëm ka zënë veprimtaria me letrat me vlerë, më konkretisht investimet, monitorimi i impakteve në portofol të investimeve, aplikime të provave të rezistencës në terma likuiditeti e të normave të interesit, analiza të ecurive të normave të interesit, analiza produktesh, kërkim/analiza tregu, monitorim treguesish të brendshëm etj.

Z. Hakani është licencuar nga AMF si Broker në Tituj dhe ka qenë Broker i autorizuar nga Bursa Shqiptare e Titujve.

Z. Hakani është diplomuar në vitin 2005 nga Universiteti i Tiranës, në degën “Financë”.

1.3.3 Administratori

Administratori i shoqërisë është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit të Administrimit. Ai drejton dhe organizon aktivitetin e shoqërisë administruese, harton dhe i propozon Këshillit të Administrimit të gjitha procedurat dhe rregulloret e brendshme, perfaqëson shoqërinë me palet e treta dhe siguron që ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë është në përputhje me plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Z. Redi Hakani – Administrator i Përgjithshëm

1.3.4 Personeli kyç

Personeli kyç do të jetë:

Z. Redi Hakani – Administrator i Përgjithshëm – Përgjegjës i Zyrës Kryesore (Operative) me përgjegjësi kryesore, por jo limituara vetëm tek të mëposhtmet:

- Menaxhimin e investimeve sipas prospekteve të dizenuara për çdo fond;
- Organizimin e shitjeve të fondeve të investimeve nëpërmjet kanaleve shitëse;
- Përgatitjen e materialeve të marketing-ut për fondet;
- Kryerjen e analizave të ndryshme për optimizimin e kthimeve të investimeve; etj

1.4 Delegimi i funksioneve të shoqërisë administruese të palët e treta

Shoqëria administruese ABI Invest ka vendosur të delegojë një pjesë të funksioneve të përcaktuara në ligjin 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, ABI Bank Sh.a. Shoqëria deklaron se delegimi është kryer duke patur parasysh interesin më të mirë të investitorëve, si edhe pavarësisht faktit se këto funksione janë deleguar, Shoqëria Administruese do të mbetet përgjegjëse për çdo veprim apo mosveprim në lidhje me funksionet e deleguara.

Shoqëria administruese ka lidhur marrëveshje shërbimi, me ABI Bank Sh.a. në lidhje me kryerjen e plotë apo të pjesshme të funksioneve sa më poshtë:

- Burimet Njerëzore
- Auditimi i Brendshëm
- Shitja dhe veprimtaria e ABI Bank Sha.në rolin e agjentit
- Teknologjia e Informacionit
- Marketingu
- Përputhshmëria dhe Parandalimi i Pastrimit të Parave

1.5 Konflikti i interesit në lidhje me funksionet e deleguara

Shoqëria administruese ka vendosur të delegojë funksionet e mësipërme te shoqëria mëmë Banka Amerikane e Investimeve. Shoqëria mëmë që ka marrë përsipër kryerjen e funksioneve të deleguara ka marrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me:

- Identifikimin dhe adresimin e konfliktit të interesit
- Kuadrin rregullativ të brendshëm në lidhje me shmangjen apo parandalimin e konfliktit të interesit

2. FONDI I INVESTIMIT

2.1 Fondi ABI FLEX USD – Sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike

Fondi i investimit ABI FLEX USD është një sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, i krijuar nga ABI INVEST. Ky fond është me kohëzgjatje të papërcaktuar.

Monedha e fondit është USD që nënkupton se fondi emëton dhe shlyen kuotat në USD

Fondi i investimit ABI FLEX USD është një fond që do të ketë ekspozim ndaj një shumëllojshmërie aktivesh, të cilat mund të përfshijnë obligacione, aksione, apo investime në në kuota apo aksione të fondeve të tjera të investimit. Fondi zbaton strategjinë e tij të investimit duke patur parasysh parimin e diversifikimit të riskut dhe strategjinë e investimeve, në përputhje me Parashikimet e Ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Fondi ABI FLEX USD nuk mbështetet në asnjë formë nga ABI BANK ose ABI INVEST si për garantimin e likuiditetit, ashtu edhe të stabilitetit të vlerës neto të aktiveve, nuk është një produkt bankar dhe risku i investimit në të i përket tërësisht investitorit.

Investimi në fond nuk është një depozitë bankare dhe si i tillë nuk është i siguruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave!

2.2 Krijimi i fondit dhe kohëzgjatja

Fondi u themelua më datë 05.03.2021, dhe u licensua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiar e me licensën nr 11 datë 30.06.2021 vendimi nr. 112. Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe ka filluar veprimtarinë e tij më 18 Tetor 2021. Periudha e ofertës fillestare fillon më 18 Tetor 2021 dhe përfundon më 17 Nëntor 2021. Aktualisht nuk ka të dhëna mbi performancën e fondit në të shkuarën.

2.3 Qëllimi i investimit dhe politika e investimit

Fondi ABI FLEX USD është një fond i cili ka ekspozim ndaj një shumëllojshmerie aktivesh. Fondi ka si synim rritjen e moderuar të kapitalit dhe synon të investojë në tregun e obligacioneve direkt duke investuar në llojet e obligacioneve të përcaktuara në politikën e investimit apo indirekt duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këto instrumenta.

Fondi do të investojë pjesërisht në tregun e aksioneve direkt nëpërmjet investimit në kuota apo aksione të shoqërive tregtare apo indirekt nëpërmjet investimit në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat kanë ekspozim në këtë treg.

Për arsye diversifikimi një pjesë e vogël e aktiveve të fondit mund të shpërndahet gjithashtu edhe në tregun e metaleve të çmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo të tjera, duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këto tregje.

Fondi do të investojë gjithashtu në instrumenta të tregut të parasë, dhe në depozita bankare me qëllim menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit.

Fondi mund të investojë më tepër se 35% të aktiveve të tij, në tituj të emëtuar nga një emëtues i vetëm me kusht që të jenë emëtuar apo garantuar nga një prej shteteve të BE apo Republika e Shqipërisë.

Fondi menaxhohet në mënyrë pasive apo aktive sipas gjykimit të menaxherëve të fondit dhe pritshmërive që menaxherët e fondit do të kenë mbi ecurinë e tregjeve financiare. **Ai nuk kufizohet nga ndonjë benchmark (tregues reference) i veçantë**

2.3.1 Qëllimi i investimit

Qëllimi i investimit të Fondit është realizimi i një rritje të moderuar të kapitalit në një periudhë afatmesme, kryesisht nëpërmjet investimeve në klasa ndryshme aktivesh, duke përzgjedhur strategji të përshtatshme diversifikimi. Si i tillë fondi do të investojë në obligacione, aksione apo sipërmarrje të tjera investimesh kolektive të klasifikuara si UCITS, dhe gjithashtu mund të investojë deri në 30% të totalit të aktiveve në sipërmarrje të investimeve kolektive të cilat nuk janë të klasifikuara si UCITS.

Investimet në sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive do të përzgjidhen duke marrë parasysh cilësinë e procesit të investimit, performancën e tyre deri në datën e investimit si dhe menaxhimin e tyre të riskut.

Fondi është i përshtatshëm për ata investitorë që janë të gatshëm të ndëmarrin një nivel më të lartë rreziku dhe përfitimi duke investuar në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

2.3.2 Strategjia e investimit dhe shpërndarja e aktiveve

Fondi do të investojë në pëputhje me politikën e tij të investimit duke blerë dhe shitur instrumenta financiarë (obligacione, aksione, instrumenta të tregut të parase, kuota apo aksione në fonde të tjera investimi). Menaxherët e fondit do të vlerësojnë ecurinë e tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, si edhe trendet kryesore të këtyre tregjeve. Gjatë kryerjes së investimeve fondi do të ketë si qëllim diversifikimin e portofolit, në klasa dhe lloje të ndryshme aktivesh.

Menaxherët e fondit mund të përzgjedhin një strategji aktive të menaxhimit të aktiveve ose një strategji pasive. Në rastet e përzgjedhjes së strategjisë aktive, sipas gjykimit mund të ndjekin një strategji investimi që orientohet nga vlera (value), potenciali i rritjes (growth), analiza teknike e historikut të lëvizjeve të çmimit të instrumentave financiarë etj.

Aktivet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin kategorive të mëposhtme:

Obligacione qeveritare të emëtuara nga: Vendet e BE, SHBA, Zvicra, Britania e Madhe, Kanadaja, Australia, vendet e paqësorit, vendet e tregjeve në zhvillim (emerging markets), Republika e Shqipërisë apo vendet e rajonit, si dhe obligacione të emëtuara nga shoqëri tregtare të listuara dhe pranuar për tregtim në tregjet e rregulluara të:

- a) vendeve të zhvilluara të tilla si: BE, SHBA, Zvicra, Britania e Madhe, Kanadaja, Australia apo vendet e paqësorit
- b) Të Republikës së Shqipërisë, vendeve të rajonit apo vendeve në zhvillim (emerging markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine apo Azi.

Investimet në obligacione mund të jene direkt ose indirekt nëpërmjet investimit në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në këto lloj instrumentash.

Obligacionet mund të jenë standarte, ose të nënrenditura (subordinated).

Aksione të shoqërive tregtare, pjesë përbërëse e bursave të:

- a) Vendeve të zhvilluara të tilla si BE, SHBA, Zvicra, Kanadaja, Britania e Madhe, Australia apo vendet e paqësorit
- b) Vendeve në zhvillim (Emerging Markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine ose Azi

Investimet në aksione mund të jenë direkt ose indirekt nëpërmjet investimit në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në aksione

- Kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në tregun e obligacioneve, të aksioneve, ose përdorin një strategji mikse të investimit duke u ekspozuar njëkohësisht në shumë tregje.
- Kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në tregun e metaleve të cmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo të tjera.

Instrumenta të tregut të parase dhe ekuivalentë cashi

Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon synon ndjekë një strategji fleksibël investimi, duke u pozicionuar në varësi të kushteve të tregjeve ndërkombëtare.

a) Tregu i obligacioneve

Fondi synon të investojë në obligacione drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive.

Përzgjedhja e investimeve të drejtpërdrejta do të bëhet nga menaxherët e portofolit kryesisht duke patur parasysh yield, vlerësimin e obligacioneve nga agjensitë e vlerësimit të kreditit si edhe likuiditetin apo tregtueshmërinë e tyre në tregjet ndërkombëtare.

Fondi mund të investojë një pjesë të konsiderueshme të asetëve në obligacione të vlerësuara si “nën gradë investimi” apo pjesërisht edhe në obligacione të cilat nuk janë të vlerësuara. Kjo strategji investimi ka si synim kryesor të zgjerojë yieldin që përfiton fondi, duke përdorur ndërkohë investime në aktive të tjera me qëllimin e reduktimit të rrezikut të portofolit.

Fondi mund të investojë edhe në obligacione të nënrenditura (subordinated) të emëtuara nga Banka apo institucione financiare, me synimin e zgjerimit të yieldit total të fondit në një periudhë afatmesme.

Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të cilat investojnë në obligacione, përzgjedhja e tyre do të bëhet duke marrë parasysh performancën e fondit, vlerësimin/renditjen e aktiveve që ka investuar fondi, eksperiencën e menaxherëve të fondit si edhe procesin e menaxhimit të riskut. Këto sipërmarrje mund të jenë ose jo fonde të tregtuara në bursë (ETF)

b) Tregu i aksioneve

Synimi i investimeve në tregun e aksioneve është maksimizimi i rritjes reale të portofolit në periudhë afatmesme deri afatgjatë, duke marrë një risk më të lartë sesa investimet në tregun e titujve të borxhit, dhe duke u ekspozuar ndaj një luhatshmërie më të lartë.

Fondi investon në këtë treg në mënyrë direkte duke investuar në aksione individuale apo indirekte duke investuar në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këtë klasë aktivesh. Këto fonde janë të mirëdiversifikuara, ato mund të jenë të manaxhuar në mënyrë aktive, ose të jenë të tregtuara në Bursë (ETF). Ekspozimi i tyre mund të jetë global, ose i përqëndruar në një rajon apo sektor specifik.

Në rastet e investimit në mënyrë indirekte, pesha specifike e secilit fond në portofol ndryshon bazuar mbi pritshmëritë për potencialin e rritjes që kanë menaxherët e fondit por ajo nuk tejkalon më tepër se 10% në një sipërmarrje të vetme. Investimet përzgjidhen kryesisht duke u bazuar në performancën e fondeve, procesin e menaxhimit të riskut, si dhe ekspozimin që kanë fondet në një rajon apo sektor specifik.

Investimet në fondet e tjera të investimeve përzgjidhen kryesisht duke u bazuar në cilësinë e procesit të investimit, performancën e tyre dhe menaxhimin e riskut të tyre.

c) Tregu i metaleve të çmuara

Fondi synon të investojë një pjesë të vogël të aktiveve të tij në tregun e metaleve të çmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo metale të tjera. Ekspozimi i fondit në këtë treg do të arrihet nëpërmjet ekspozimit në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në këto tregje. Këto sipërmarrje mund të jenë sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur apo fonde të tregtuara në bursë (ETF).

d) Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i

Në përgjithësi, një pjesë e vogël e aktiveve mbahet në cash apo ekuivalentë të tij, të tilla si depozita bankare me maturim deri në një vit, si edhe instrumenta të tjerë si marrëveshje të riblerjes/të anasjelltë të riblerjes, si dhe huadhënie titujsh.

Qëllimi i përdorimit të investimeve në tregun e parasë, si depozita dhe transaksione të marrëveshjes së riblerjes / të anasjelltë të riblerjes është të mbulojë nevojat e likuiditetit afatshkurtër të Fondit duke përbushur edhe detyrimet ligjore ndaj investitorëve brenda afateve të përcaktuara. Fondi gjithashtu mund të japë hua titujt që ka në pronësi, me qëllimin e rritjes së fitimeve të fondit, në bazë të një marrëveshje të huadhënies së titujve.

2.3.2.2 Shpërndarja e aktiveve

Bazuar në politikën e investimit, shpërndarja e aktiveve të fondit do të bëhet duke marrë parasysh ekspozimin sipas tregut, si dhe sipas llojit të instrumentave ku do të investohet në secilin treg të synuar. Shpërndarja strategjike e aktiveve nënkupton që fondi do të synojë të investojë kryesisht në këto lloj aktivesh, ajo nuk nënkupton një detyrim nga ana e fondit për të investuar sipas shpërndarjes të përcaktuar në tabelën e shpërndarjes së fondit.

Menaxherët e portofolit do të gjykojnë sipas rastit dhe kushteve të tregut dhe mund të devijojnë nga shpërndarja e synuar.

Nuk ka kufizim në lidhje me masën e këtij devijimi, nga shpërndarja e synuar që nënkupton se maksimumi i ekspozimit në secilin treg apo nënkategoritë e përcaktuara në tabelën e shpërndarjes së aktiveve mund të shkojë nga 0% deri në 100%, me kusht që të respektohen në cdo kohë të gjitha kufizimet ligjore të përcaktuara në nenin 139 dhe 140 të ligjit 56/2020 dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij.

Në tabelën më poshtë është paraqitur **shpërndarja strategjike afatgjatë e aktiveve**, e përcaktuar nga Politika e Investimit të jetë si më e përshtatshme, duke pasur parasysh objektivin afatgjatë të fondit.

TABELA E SHPËRNDARJES SË AKTIVEVE

<i>Ekspozimi sipas tregut</i>	<i>Nenkatgoria sipas llojit të instrumentit</i>	<i>Shperndarja e synuar</i>
Tregu i Parase dhe Ekuivalentë Cashi		10%
	Depozita, llogari rrjedhëse, marrëveshje të anasjellta riblerje nga banka brenda dhe jashtë vendit.	10%
Tregu i Obligacioneve		55%
	Obligacione, të emëtuara nga shtetet anëtare të BE, vendet e tregjeve në zhvillim (emerging markets), Republika e Shqipërisë apo vendet e rajonit, si dhe obligacione të emëtuara nga shoqëri tregtare të pranuar për tregtim në tregjet e rregulluara të vendeve të zhvilluara si ,BE, SHBA, Zvicër, Britaninë e Madhe, Kanada, Australi apo vendet e paqësorit ose në tregjet e rregulluara të Republikës së Shqipërisë, vendeve të rajonit apo vendeve në zhvillim (emerging markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine apo Azi, apo kuota ose aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në obligacione.	55%
Tregu i Aksioneve		30%
	Aksione të shoqërive tregtare, kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në aksione, pjesë përbërëse e bursave të vendeve të zhvilluara të tilla si BE, SHBA, Zvicra, Kanadaja, Britania e Madhe, Australia apo vendet e paqësorit ose vendeve në zhvillim (Emerging Markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine ose Azi	30%
Tregu i Metaleve të Cmuara		5%
	Kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në tregun e metaleve të cmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo të tjera	5%

2.3.2.3 Instrumentat e politikës së investimit

Instrumentët që do të përdoren në zbatimin e politikës së investimit janë si më poshtë:

- a. Tituj të transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të pranuar në listën zyrtare në një treg të rregulluar osë bursë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në një vend anëtar të BE-së, SHBA, Zvicrës, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë, vendeve të paqësorit, Vendeve në zhvillim në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine apo Azi.
- b. Kuota të apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive me ofertë publike
- c. Depozita Bankare
- d. Marrëveshje të riblerjes dhe huadhënie titujsh
- e. Instrumenta financiare derivative

Në cdo rast shoqëria administruese do të zbatojë të gjitha kufizimet e përcaktuara nga neni 139 dhe neni 140 i ligjit 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” si dhe rregulloreve të AMF në lidhje me investimet dhe huamarrjen.

Kufizime në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive

Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive fondi do të zbatojë kufizimet e përcaktuara nga ligji 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” si në vijim:

- a) Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike*

Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme.

- këto sipërmarrje të jenë të licencuara, në një prej vendeve të Bashkimit European, SHBA, Kanada, Zvicër, Britaninë e Madhe, apo Australi nga Autoritetet përkatëse rregullatore
- këto sipërmarrje nuk investojnë më tepër se 20% të aktiveve të tyre në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive
- niveli i mbrojtjes për pjesëmarrësit në këto sipërmarrje të jetë i barasvlershëm me atë që parashikohet për pjesëmarrësit në sipërmarrjen e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti me rregullat për veçimin e aktiveve, huamarrjen, huadhënien dhe shitjen e pambuluar të titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë që janë të barasvlershme me kërkesat e ligjit 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”
- veprimtaria e sipërmarrjeve të tjera të raportohet në raportet vjetore dhe të ndërmjetme dhe në pasqyrat financiare për të mundësuar vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve, të ardhurave dhe veprimtarisë gjatë periudhës së raportimit

Kuotat apo aksionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive të cilat nuk janë të klasifikuara si UCITS, në përputhje me direktivën 2009/65/EC nuk mund të tejkalojnë në tërësi më tepër se 30% të aktiveve të fondit.

- b) Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive të cilat janë UCITS*

Kuotat apo aksionet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të cilat janë të klasifikuara si UCITS në përputhje me direktivën 2009/65/EC, mund të tejkalojnë më tepër se 30% të aktiveve të fondit.

c) *Në lidhje me kufizimin për investim në një sipërmarrje të vetme*

Fondi nuk investon më tepër se 10% të aktiveve në një sipërmarrje të vetme.

Sqarim për teknikat e përdorimit të derivativeve

Fondi mund të përdorë instrumenta financiare derivative me qëllimin e zbatimit të një strategjie mbrojtje nga risku. Instrumentat derivative mund të shlyhen fizikisht ose në para. Instrumentat derivative mund të përfshijnë instrumenta që lidhen me normën e interesit, kursin e këmbimit apo instrumenta specifike në të cilët investon fondi sipas politikës së investimit. Fondi do të hyjë në transaksione në instrumenta derivative vetëm me kundërpalë të cilat konsiderohen si institucione të mbikëqyrura, të licensuara për të kryer këto transaksione nga AMF, Banka e Shqipërisë apo ndonjë autoritet tjetër rregullator i vendeve të Bashkimit Europian, SHBA, Kanadasë, Zvicrës, Britanisë së Madhe apo Australisë. Fondi do të përdorë këto instrumenta vetëm në rastin kur këto instrumenta janë subjekt i vlerësimit ditor, dhe në cdo kohë me iniciativën e shoqërisë administruese mund të shiten me çmimin aktual të tregut, mund të likuidohen ose të kundërbalancohen nëpërmjet një transaksioni të kundërt.

Risqet që shoqërojnë përdorimin e derivativeve janë sqaruar në seksionin 2.4.1.6 te rubrika Faktorët e Riskut

Sqarim për transaksionet e rfinansimit të titujve:

a) *Marrëveshjet e Riblerjes*

Shoqëria administruese kur e gjykon të arsyeshme dhe në përputhje me politikën e investimit do të përdorë marrëveshjet e riblerjes apo të anasjellta të riblerjes, për një menaxhim eficient të likuiditetit si edhe për të reduktuar riskun e kreditit të kundërpartisë.

Titujt që do të merren në konsideratë janë titujt e përcaktuar në politikën e investimit. Këto tituj kalojnë në llogarinë e fondit

Një marrëveshje riblerje nënkupton shitjen e titujve me kushtin për ti riblerë ato me një çmim të paracaktuar në një datë të ardhshme, ndërkohë që një marrëveshje e anasjelltë e riblerjes nënkupton blerjen e titujve me kushtin për t'i rishitur ato me një çmim të paracaktuar në një datë të ardhshme. Rreziqet që shoqërojnë marrëveshjet e riblerjes janë përcaktuar në seksionin 2.4.1.5 (a) Rubrika faktorët e riskut

b) *Huadhënia e titujve*

Brenda kufijve të lejuar të investimit, shoqëria administruese mund të japë hua titujt vetëm nëse kjo huadhënie sigurohet nëpërmjet një sistemi të njohur dhe të licencuar të klerimit dhe të shlyerjes së titujve, për afate të shkurtra, dhe me kusht që pala tjetër me të cilët lidhet marrëveshja e huadhënies së titujve, detyrohet që të ritransferojë titujt pas një periudhe të caktuar.

Tarifa e marrë gjatë huadhënies së titujve është një burim tjetër i të ardhurave të fondit. Llojet e titujve që do të përdoren në një transaksion të huadhënies së titujve janë ato të përcaktuara në politikën e investimit. Titujt e dhëna hua nuk mund të tejkalojnë më tepër se 10% të aktiveve të fondit.

Për cdo titull të dhënë hua shoqëria do të sigurohet që egziston kolateral i mjaftueshëm i cili mund të jetë në dy forma

- Cash i bllokuar në llogari të fondit.
- Titujt të tjerë të bllokuara në një sistem të klerimit dhe shlyerjes së titujve në favor të fondit, nëpërmjet një nënkujdestari ose jo, të cilët mund të jenë obligacione me cilësi të kreditit të paktën Baa3

Vlerësimi i kolateralit

Në rastet kur kolaterali përbëhet nga titujt të tjerë ky kolateral do të vlerësohet cdo ditë. Kolaterali do të mbahet në llogari të veçantë nga Banka Depozitare dhe nuk do të ripërdoret.

Rreziqet që shoqërojnë transaksionet e huadhënies të titujve janë përcaktuar në seksionin 2.4.1.5 (b) Rubrika faktorët e riskut.

2.4 Faktorët e rrezikut

Investimet e fondit në aktivet të cilat janë të përcaktuara në politikën e investimit të këtij fondi shoqërohen me një sërë rreziqesh ashtu si edhe me mundësinë për të përfituar. Nëse investitori shet kuotat e fondit në kohën kur mimet e këtyre aktiveve kanë rënë, ai mund të pësojë humbje nga shuma të cilën ai e ka investuar në fond. Sidoqoftë risku i investitorit është i limituar në shumën e kapitalit të investuar në fond, që nënkupton se ai nuk është i detyruar të investojë kapital shtesë në rast humbjeje.

Rreziqet e paraqitura më poshtë i aplikohen në veçanti fondit të investimit ABI FLEX USD

2.4.1 Risqet e lidhura me investimin

Fondi i investimit ABI FLEX USD do të investojë në aktivet e përcaktuara në politikën e investimit. Investimet e fondit në këto tregje do të shoqërohen me një sërë rreziqesh të cilat janë përcaktuar më poshtë:

2.4.1.1 Risku i Tregut

Risku i Tregut është mundësia për një investitor të pësojë humbje si rezultat i luhatjes së vlerës së instrumentave financiare në portofolin e fondit. Ky fond investon specifikisht në klasa aktive të cilat ndikohen nga risku i tregut.

a) Risku që e gjithë klasa e aktiveve në portofolin e fondit performon negativisht

Performanca e titujve në portofolin e fondit varet veçanërisht nga performanca e tregjeve të kapitalit. Për këtë arsye egziston mundësia që kjo performancë të jetë negative pavarësisht se fondi ka një nivel të lartë diversifikimi.

b) Risku që shoqërohet nga lëvizja e çmimit të tregjeve të çmimit të aksioneve

Risku i lëvizjes së çmimit të aksioneve është një formë e riskut të tregut. Ky risk lidhet me luhatshmërinë e lartë që kanë këto tregje. Në veçanti, çmimi i aksioneve mund të bjerë më poshtë sesa çmimi me të cilin fondi ka investuar në këto tregje, dhe si rezultat fondi mund të pësojë humbje. Fondi i investimit ABI FLEX USD synon të investojë pjesërisht në këto tregje, direkt ose indirekt duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive që kanë ekspozim me këto tregje. Në rastin e investimeve në fonde të tjera investimi me ofertë publike që investojnë në tregjet e aksioneve, kuotat e këtyre fondeve do të kenë luhajta në varësi të lëvizjes së tregjeve të aksioneve.

c) Risku i normave të interesit

Titujt e borxhit janë të ekspozuar ndaj riskut të normave të interesit. Nëse normat e interesit të tregut do të pësonin rritje, atëherë vlera e titullit në portofolin e fondit do të binte, dhe anasjelltas nëse normat e interesit do të pësonin ulje atëherë vlera e titullit në portofolin e fondit do të rritej. Si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit investitori do të pësonte humbje të kapitalit gjatë periudhave afatashkurtra.

Njësia matëse e riskut të tregut të lidhur me lëvizjen e normave të interesit është “Kohëzgjatja e modifikuar” apo “Duration” i cili mat ndjeshmërinë e lëvizjes së çmimit të titullit në portofolin e fondit në raport me lëvizjen e normave të interesit. Kohëzgjatja e modifikuar është e lidhur ngushtë me maturitetin e titujve në portofolin e

fondit. Sa më i lartë të jetë ky tregues “Kohëzgjatja e modifikuar” aq më i lartë do të jetë edhe ndjeshmëria e fondit ndaj lëvizjes së normave të interesit.

d) Risku i kursit të këmbimit

Risku i kursit të këmbimit, është mundësia performanca e fondit të ndikohet negativisht nga lëvizjet e kursit të këmbimit. Sipas gjykimit të menaxherëve të fondit, rast pas rasti mund të investohet në tituj të emëtuar në monedha të ndryshme nga monedha e fondit (USD). Në këto raste fondi do të ekspozohet nga lëvizjet e kursit të këmbimit, të cilat mund të ndikojnë negativisht në çmimin e kuotës.

e) Risku i levizjes së tregut të metaleve të cmuara

Tregu i metaleve të cmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo te tjera është i ekspozuar ndaj rreziqeve të cilat janë tipike për keto lloj tregjesh dhe të cilat mund të ndikojnë negativisht çmimin e kuotës si: lëvizje të forta në kërkesën apo ofertën për metalin e cmuar, ndërhyrje qeveritare, shkatërrime natyrore, lufta apo ngjarje të tjera të jashtëzakonshme.

2.4.1.2 Risku i likuiditetit.

Risku i likuiditetit ka të bëjë me mungesën e tregtueshmërisë së një instrumenti financiar në portofolin e fondit, dhe pamundësisë për tu shitur ose blerë, shpejt dhe pa ndikuar çmimin e instrumentit në treg. Si rezultat shoqëria administruese mund të haste vështirësi në lidhje me detyrimin për të shlyer kuota për shkak të mungesës së likuiditetit në treg, dhe pamundësisë për të shitur instrumentat financiare në portofolin e fondit. Ky fond investon kryesisht në instrumenta financiare të listuara dhe të tregtuara në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, të cilat konsiderohen si aktive likuide me cilësi të lartë.

Sidoqoftë mund të egzistojnë situata të veçanta të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të rëndësishme likuiditetin e këtyre tregjeve, dhe rrjedhimisht dhe aftësinë e shoqërisë administruese për të shitur instrumentat financiare. Si shëmbull gjatë një krize financiare likuiditeti i instrumentave financiarë në tregjet e kapitalit bie dhe shoqëria mund të mos ketë mundësi të likuidojë titujt apo instrumentat financiarë në portofolin e saj.

2.4.1.3 Risku i Kreditit

Nënkupton situatën kur një emëtues i titujve të borxhit në portofolin e fondit ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese dhe si rrjedhojë nuk paguan detyrimet e tij në formën e kuponit apo principalit. Risku i kreditit të titujve të borxhit vlerësohet nga Agjensitë e Vlerësimit të Riskut të Kreditit. Ky vlerësim reflekton aftësinë paguese të emëtuesit, si edhe shërben si një bazë krahasuese për aktivet të cilat kanë një vlerësim më të lartë në raport me aktivet të cilat kanë një vlerësim më të ulët.

Vlerësimi i kreditit (renditja) nga Moody’s varion nga nota Aaa që përfaqëson riskun më të ulët në notën C që përfaqëson një situatë të paaftësisë paguese. Një ulje në vlerësim nga një notë më e lartë në një notë më të ulët nënkupton një rritje të riskut të kreditit dhe mund të ndikonte në uljen e çmimit të titullit të borxhit në portofolin e fondit.

Fondi mund të investojë në tituj borxhi të cilët janë të vlerësuar si gradë investimi, të cilët konsiderohen të tillë kur vlerësimi i kreditit (renditja) është në notën Baa3 e sipër (sipas Moody’s).

Fondi mund të investojë gjithashtu në tituj borxhi të cilët janë të vlerësuar me “nën gradë investimi”, të cilët konsiderohen si të tillë kur vlerësimi i kreditit (renditja) është në notën Baa3 (Sipas Moody’s). Këta tituj kanë një risk të kreditit më të lartë se titujt që vlerësohen si gradë investimi.

Fondi mund të investoje edhe në shoqëri tregtare të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë apo vendet Europiane në zhvillim të cilat nuk janë vlerësuar nga ndonjë agjensi e vlerësimit të kreditit. Këta tituj zakonisht kanë një risk krediti më të lartë se titujt që janë të vlerësuar mbi gradë investimi.

Gjithashtu, nëse titujt në portofolin e fondit do të zhvlerësoheshin nga një notë me cilësi më të lartë në një notë me cilësi më të ulët, investitori mund të pësonte humbje. Një formë tjetër e riskut të kreditit është dhe risku i pjesëmarrjes së kreditorëve, në rastet e rikapitalizimit nga brenda të bankave (bail in). Në këtë rast kreditorët e bankës mund të pësojnë humbje totale të kapitalit të investuar.

2.4.1.4 Risku i lidhur me obligacionet e nënrenditura (SUBORDINATED)

Obligacionet e nënrenditura (subordinated), janë tituj borxhi shlyerja e të cilave në rast falimenti vjen pasi janë ekzekutuar të gjitha detyrimet e tjera. Këto instrumenta përdoren kryesisht nga bankat/institucionet e kreditit për tu klasifikuar si kapital i nivelit të dytë (tier 2). Gjithashtu këto instrumenta janë subjekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe mund të përdoren si një mjet për të realizuar rikapitalizimin nga Brenda (Bail in tool), ku si rrjedhojë mund të zhvlerësohen dhe konvertohen në kapital nga Banka Qëndrore me qëllimin e rritjes së kapitalit rregullator të Bankës që ka emëtuar këto instrumenta.

Për këtë arsye risku i humbjes në këto lloj instrumentash është më i lartë sesa instrumentat tradicionalë, dhe si rrjedhojë mbartin një risk më të lartë të emëtuesit.

2.4.1.5 Risqet në lidhje me transaksionet e rifinancimit të titujve

a) Risqet që shoqërohen me transaksionet e huadhënies së titujve.

Në rastin kur fondi i investimeve jep hua tituj, egziston risku që huamarrësi i titujve të ndodhet në kushtet e paftësisë paguese, duke mos i kthyer mbrapsht titujt e marrë hua. Ndërkohë huamarrësi i titujve vendos kolateral për titujt e marrë hua duke e ekspozuar fondin në lidhje me riskun e kolateralit. Për më tepër në lidhje me transaksionet e huadhënies së titujve mund të ketë dhe rrisqe operationale të tilla si gabime në lidhje me kontabilizimin e tyre. Ndërkohë huamarrësi i titujve I përdor titujt e marrë hua, dhe për këtë arsye ato janë subjekt i riskut që në përfundim të transaksionit, huamarrësi i këtyre titujve nuk do të jetë në gjëndje të blejë ato me çmimin e tregut.

b) Risqet që shoqërohen me marrëveshjet e riblerjes/të anasjellta të riblerjes

Përdorimi i marrëveshjeve të riblerjes / të anasjellte të riblerjes mund të shoqërohet me rreziqe të tillë si risk i palës tjetër që nuk shlyen detyrimet në kohë, risk i tregut për shkak të ndryshimit që mund të pesojë vlera e titujve të marrë në zotërim në rastin e një marrëveshje të anasjellte të riblerjes. Për shëmbull në një marrëveshje të anasjellte të riblerjes nëse shitësi i titujve do të ndodhej në kushtet e paftësisë paguese, dhe çmimi i tregut të titujve të blerë do të binte poshtë nivelit të shumës së paguar nga fondi në momentin fillestar, atëherë fondi do të pësonte humbje, të barabartë me diferencën e çmimit të shitjes së titujve në treg me shumën e paguar në momentin fillestar

2.4.1.6 Risku në lidhje me instrumentat derivative

Shoqëria administruese mund të përdorë instrumenta derivativë, të cilët do të përdoren kryesisht me qëllimin për të krijuar një mbrojtje ndaj ekspozimeve të ndryshme që mund të ketë shoqëria. Pavarësisht përpjekjeve të shoqërisë duhet theksuar se instrumentat derivative mbajnë disa rreziqe si ne vijim:

- Të drejtat mbi instrumentin tek i cili mbështetet derivativi (underlying instrument) mund të humbasin vlerë. Ulja e çmimit mund të sjellë humbje për fondin.

- Risku i humbjes mund të mos jetë lehtësisht i matshëm/parashikueshëm dhe mund të tejkalojë vlerën e kolateralit që mund të jetë marrë si mbrojtje.
- Në rast shitjeje për të ulur riskun e lidhur me derivativët, transaksionet mund të mos jenë të mundura të kryhen me çmimin e vlerësimit, pasi nuk janë tituj shumë likuidë.

2.4.1.7 Risku i palës tjetër

Kjo kategori e riskut përfaqëson mundësinë që shlyerja në një sistem transfertash nuk përmbushet si duhet nga kundërpria e cila mund të mos paguajë, ose mund të vonojë pagesën. Risku i shlyerjes lidhet me mos marrjen e shumës korresponduese pas përmbushjes së një transaksioni.

2.4.1.8 Risku i Inflacionit

Përfitueshmëria nga investimi i aktiveve të Fondit ka tendencë të ndikohet negativisht nga presionet inflacioniste. Në përgjithësi rënia e vlerës së parasë shoqërohet me rënie të fuqisë blerëse të investitorit në Fond, por nga ana tjetër edhe me rritje të ndjeshme të normave të interesit në treg. E parë në plan të përgjithshëm, inflacioni shoqërohet me pasiguri dhe nuk ndihmon në stabilitetin e investitorëve dhe kthimeve në Fond.

2.4.1.9 Risku i përballjes me shlyerje në shuma të mëdha

Në bazë të madhësisë së shumës së kërkuar për shlyerje (gjithnjë e vënë përballë madhësisë së aktiveve të Fondit), Fondi mund të vendoset përballë faktit të shitjes, të pjesshëm e proporcional me kërkesat për shlyerje, në mënyrë të menjëhershme nga portofoli i aktiveve të tij. Kjo mund të ketë një efekt negativ në performancën e Fondit, sepse shitja e detyruar dhe e paparashikuar e një instrumenti financiar në mënyrë të parakohshme mund të rezultojë në rënie të çmimit të kuotës.

2.4.1.10 Risku kur vlerësimi i aktiveve të disa prej titujve devijon nga çmimi aktual i shitjes për shkak të mungesës së likuiditetit të tregut.

Veçanërisht në raste të mungesës së likuiditetit në treg, i cili mund të ndodhe për shkak të krizave financiare të cilat zakonisht shkaktojnë humbje të besueshmërisë në treg, përcaktimi i çmimit për disa tituj dhe instrumenta të tjerë financiarë në tregjet e kapitalit mund të kufizohet, duke dëmtuar vlerësimin e fondit. Në rastet kur investitorët në të njëjtën kohë paraqesin kërkesa për shlyerje në sasi të mëdha të kuotave, gjatë këtyre periudhave, për të mbajtur nivelin total të likuiditetit të fondit, shoqëria administruese mund të detyrohet të shesë këto tituj me çmime që ndryshojnë nga çmimi aktual me të cilin janë vlerësuar.

2.4.1.11 Risku i mos-diversifikimit të portofolit

Sipas politikës së investimit fondi mund të investojë më tepër se 35% në një titull të vetëm, subjekt i kushteve të përcaktuara në nenin 140 të ligjit 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si rrjedhojë për shkak të këtij ekspozimi, ndikimi në lëvizjen e çmimit të këtij titulli do të ketë një ndikim të lartë për portofolin e fondit në tërësi.

2.4.2 Risqet e lidhura me Shoqërinë Administruese

Shoqëria administruese përballet së brendshmi me risqe me natyrë biznesi që lidhen me aktivitete ditore e periodike (shembull: realizimi i transaksioneve në sistem, proçeset e mbikëqyrjes, implementimi e zhvillimi i produktit etj) dhe rreziqe të përputhshmërisë si rezultat i detyrimeve e masave rregullatore gjithnjë e në rritje, ndër të tjera në kuadër të mbrojtjes së investitorit, të programeve të transparencës etj. Të gjitha sa më lart që përblidhen tek risqet e lidhura me aktivitetet e shoqërisë administruese ose me aktivitetet e fondit të investimit nën menaxhim që sjellin humbje të natyrës së shkëputjes së proçeseve apo funksioneve organike të brendshme dëmtojnë shoqërinë administruese dhe mund të vënë në risk reputacionin e rrjedhimisht biznesit e saj dhe të investitorëve.

2.4.2.1 Risku Operacional

Risku operacional është risku i humbjes nga procedura të brendshme të papërshtatshme dhe nga mosfunksionimi në lidhje me sistemet dhe stafin e shoqërisë administruese ose palës së lidhur e cila kryen disa funksione të deleguara për shoqërinë administruese, ose që rezulton nga ngjarje të jashtme dhe që përfshin risqe ligjore, risqe dokumentacioni dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregtimit, shlyerjes dhe vlerësimit, të cilat zbatohen nga fondit;

2.4.2.2 Risku Rregullator

Ka të bëjë me ekspozimin e fondit ndaj ndryshimeve të mundshme në kuadrin ligjor-rregullativ, tatimor etj. Masa shtrënguese shtesë të cilat mund të aplikohen si rezultat i ndryshimeve rregullative apo fiskale mund të kenë impakt negativ në vlerën e aktiveve të fondit.

2.4.2.3 Risku i Personelit Kyç

Në ecurinë e fondit, kontribut të konsiderueshëm ka aftësia intelektuale dhe profesionale e personave apo funksioneve përgjegjës dhe personelit kyç, përfshirë veprimet dhe vendimmarrjet e përshtatshme të Këshillit të Administrimit ose menaxherëve të fondit. Gjatë jetës së fondit, përbërja e personelit të shoqërisë apo organogramës së saj mund të ndryshojë me pasojë performancë më të ulët të realizimit të detyrave. Kjo performancë profesionale më e ulët mund të impaktojë në vendimmarrje më pak eficiente në investime e si rrjedhim një përfitueshmëri më të ulët për investitorët.

2.4.2.4 Risku Reputacional

Risku reputacional është risku i dëmtimit të besueshmërisë së shoqërisë në tregun ku kryen veprimtarinë e saj, duke përfshirë impaktin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht perceptimin e publikut për shoqërinë;

2.4.2.5 Risku i ardhur nga delegimi i funksioneve

Disa funksione, si për shembull shitja e fondit, i delegohen palëve të treta dhe mund të gjenerojnë risk sepse është shoqëria administruese përgjegjëse finale ligjore për funksionet e deleguara.

2.4.2.6 Risku i Agjencisë

Klasifikon riskun i cili rrjedh ushtrimi i autoritetit të shoqërisë për përfitim personal të drejtuesve të saj të cilët si rrjedhojë mund të mos veprojnë në interesin më të mirë të investitorëve.

2.4.3 Risqet me impakt tek investitorët dhe shoqëria administruese

Ekzistojnë risqe të cilat kanë impakt edhe tek investitori ashtu edhe te shoqëria administruese, si psh ndryshime legislative/rregullore që ndikojnë tek investimet ose taksat, tarifatat nga AMF apo funksionet e depozitarit.

2.4.3.1 Risku ligjor

Risku i humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë;

2.4.3.2 Risku Politik

Ka të bëjë me mundësinë e uljes së kthimit të investimeve në fond si rezultat i destabilizimit politik, krizave politike etj.

2.4.3.3 Risku i situatave të jashtëzakonshme

Situata të jashtëzakonshme të tilla si situata pandemike, lufta, apo kriza të theksuara ekonomike mund të ndikojnë në kthimin e aktiveve të fondit, si edhe mund të përbëjnë shkak për pezullimin e shlyerjes së kuotave të fondit

2.4.3.4 Risku që vjen nga pezullimi i shitjes/shlyerjes së kuotave

Si rregull, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerje të kuotave të Fondit. Nga ana tjetër e duke gjykuar në varësi të situatës dhe të momentit, shoqëria administruese mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, sipas parashikimeve të ligjit 56/2020 datë 30.04.2020. Ky pezullim mund të kërkojë nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave ose në rastet e forcës madhore.

Gjithashtu, pezullimi i shlyerjeve të kuotave mund të kërkojë edhe nga Autoriteti, në përputhje me nenin 9 të rregullores nr. 189, datë 16.12.2020 “Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe SIK”.

2.4.3.5 Risku i Depozitarit dhe Kujdestarisë

Funksioni i depozitarit kryhet nga një bankë e pavarur nga ABI Invest, e licencuar nga AMF. Pavarësisht kësaj egziston risku që aktivet që mbahen në kujdestari nga depozitari mund të pësojnë humbje si rezultat i pa aftësisë paguese, neglizhencës apo sjelljes mashtruese të depozitarit.

2.5 Shuma minimale e investimit dhe vlera e kuotës

Kuotat në Fond janë të emetuara në USD. Gjatë periudhës së ofertës fillestare të Fondit, çmimi i emetimit për kuotë është 100 USD. Periudha e Ofertës Fillestare fillon në datën 18.10.2021 deri në datën 17.11.2021.

Shoqëria administruese ABI Invest nuk ka përcaktuar shumë limit në lidhje me ofertën fillestare

Gjatë periudhës së ofertës fillestare, shuma totale e aktiveve monetare të mbledhura mbahet si depozitë dhe nuk investohet.

Pas mbarimit të ofertës fillestare, çmimi i kuotës së Fondit përlogaritet çdo ditë dhe është i barabartë me vlerën neto të aktiveve për kuotë, duke marrë për bazë çmimin e tregut për të gjitha aktivet e portofolit të Fondit.

Shuma minimale e investimit në Fond është 500 USD.

Të gjitha blerjet apo shlyerjet e kuotave në Fond do të bëhen në USD. Nëse ligjet dhe rregulloret në zbatim të tyre, do të ndryshojnë, shoqëria administruese mund të vendosë që blerja dhe shlyerja e kuotave të kryhet në një monedhë tjetër, gjithnjë pas miratimit paraprak nga AMF-ja.

Aksionari i vetëm i Shoqërisë Administruese “ABI Invest”, Banka Amerikane e Investimeve ka marrë vendimin për të investuar në fondin e investimit “ABI FLEX USD” duke blerë kuota të fondit nëpërmjet aktiveve monetare. Shuma që Banka Amerikane e Investimeve ka parashikuar të investojë gjatë periudhës së ofertës fillestare të jetë deri në 500,000 USD. Shoqëria Administruese “ABI Invest” dhe aksionari i saj i vetëm, Banka Amerikane e Investimeve do të sigurohen që shlyerja e kuotave nga ana e Bankes Amerikane te Investimeve të mos çënojë në asnjë rast treguesit e likuiditetit të fondit të brendshëm apo ato rregullatorë.

2.6 TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT

Në momentin e blerjes së kuotave në Fond, çdo investitor mund të kërkojë lëshimin e një çertifikate e cila vërteton pronësinë mbi kuotat. Çertifikata lëshohet me kërkesë të investitorit, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e mbërritjes së pagesës në Fond.

Ajo përmban:

- datën e blerjes së kuotave,
- emërtimin e fondit,
- emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese,
- numrin e kuotave të blera,
- emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave,
- vendin dhe datën e lëshimit të çertifikatës,
- nënshkrimin e personit të autorizuar të shoqërisë administruese.

Të drejtat që lidhen me pronësinë e kuotave në Fond janë:

- E drejta e informimit (raporte vjetore, gjashtë mujore etj);
- E drejta për të marrë pjesë në fitimet e Fondit, më mënyrë të përpjesshme me pjesëmarrjen e investitorit në të;
- E drejta për të shitur kuotat në çdo kohë;
- E drejta e transferimit të kuotave
- E drejta për ti këmbyer kuotat
- E drejta që aktivet e Fondit, në rast falimenti të shoqërisë administruese, të jenë objekt i së drejtës së ndarjes.

Në lidhje me detyrimet që lindin nga kuotat, mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Mbajtësi i kuotave të fondit nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kuotave të fondit. Depozitari i fondit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese, në lidhje me këtë regjistër, është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2.7 BLERJA DHE SHLYERJA E KUOTAVE

Kuotat do të ofrohen në treg nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes së Bankës Amerikane të Investimeve, duke përdorur rrjetin e degëve e më pas mund të shihet mundësia e përdorimit të kanaleve direkte të shitjes, on-line etj. Forca shitëse përbëhet nga staf i trajnuar dhe i autorizuar për shitje nga shoqëria administruese.

Gjithashtu dhe shlyerja e kuotave do të realizohet nëpërmjet degëve të Bankës Amerikane të Investimeve

Asnjë kuotë nuk mund të shlyhet me çmim tjetër përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhrin për blerjen ose shitjen e kuotave.

2.7.1 BLERJA E KUOTAVE NË FOND

Blerja e kuotave në Fond kryhet nëpërmjet:

1. pagesës së aktiveve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë aktivet e paguara si pjesë të aktiveve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e regjistrit të kuotave;
2. këmbimit të kuotave të fondeve të tjera të investimit në të njëjtën monedhë, të menaxhuara nga e njëjta shoqëri administruese;
3. nëpërmjet pagesave të rregullta, periodike, në llogarinë e fondit, në formën e planeve të programuara të investimit. Në rastin e planeve të investimit, shuma minimale e investimit në Fond është 100 USD.

Çdo pagesë për blerje kuotash kryhet në llogarinë bankare të Fondit me nr AL07 2151 1031 USD1 0000 1613 0200 të hapur pranë depozitarit, i cili është First Investment Bank, Shqipëri, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Transfertë nga llogaria e investitorit pranë Bankës Amerikane të Investimeve drejt llogarisë së Fondit tek depozitari (kundrejt tarifave në fuqi);
- Transfertë nga llogaria e investitorit pranë çdo banke tjetër të nivelit të dytë (të ndryshme nga Banka Amerikane e Investimeve) drejt llogarisë së Fondit tek depozitari (kundrejt tarifave në fuqi); Nëpërmjet një pagese të menjëhershme në llogarinë e fondit.

Të gjithë investitorët që konsiderojnë apo janë të gatshëm të blejnë kuota në Fond nëpërmjet pagesës së menjëhershme të aktiveve monetare ose nëpërmjet planeve të programuara të investimit, duhet të nënshkruajnë një kërkesë për blerje kuotash (urdher-blerje) në mënyrë që të bëhen pronarë të një numri të caktuar kuotash në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit. Periudha e investimit nis në momentin e mbërritjes së pagesës në fond dhe zgjat deri në ditën e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitjen e kuotave në ABI Invest.

Çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond konsiderohet ai i blerjes së kuotës nga investitori, i llogaritur në përputhje me ligjin nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, rregulloret në zbatim të tij, si dhe në përputhje me këtë prospekt.

Planet e programuara të investimit:

Planet e programuara të investimit janë një mënyrë investimi ku investitori angazhohet për të kryer investimin në fond nëpërmjet pagesave periodike të barabarta, të cilat mund të jenë cdo muaj, cdo tremujor, cdo gjashtëmujor ose cdo vit.

Plani i programuar i investimit lidhet për një afat kohor minimal prej 3 vjetësh deri në një afat të pacaktuar.

Shuma minimale e pagesave mujore nëpërmjet planit të programuar të investimit është 100 USD

2.7.2 Shlyerja e kuotave

Çdo investitor ka të drejtë të kërkojë në çdo moment shitjen e kuotave të tij nëpërmjet plotësimit të një formë kërkesë për shitje të kuotave të Fondit.

Shlyerja e kuotave në Fond ekzekutohet nga Shoqëria Administruese duke përdorur çmimin e zbatueshëm në datën e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për këtë veprim. Në momentin e shlyerjes, i cili është maksimumi 7 ditë kalendrike nga mbërritja e kërkesës për shitje, aktivet monetare të investitorit do të kalojnë nga llogaria e fondit të investimit pranë bankës depozitare drejt llogarisë së investitorit në një bankë të nivelit të dytë.

Shoqëria Administruese ka të drejtë që nëse brenda një dite tregtimi bëhen kërkesa për shlyerje të kuotave, për më shumë se 10 % të vlerës ose numrit të kuotave të fondit, të shtyjë shlyerjen e shumës a vlerës përtej këtij kufiri deri në pikën e ardhshme të vlerësimit. Në këtë rast shoqëria administruese garanton trajtim njëlojtë të të gjithë mbajtësve të kuotave, të cilët kërkojnë t'i shlyejnë kuotat në cilëndo pikë vlerësimi në të cilën shtyhet shlyerja e kuotave. Të gjitha tregtimet lidhur me një pikë vlerësimi të mëparshme kryhen përpara se të merren në konsideratë ato të cilat lidhen me një pikë vlerësimi të mëpasshme.

Në situata të veçanta kur shitja e aktiveve të Fondit, e pashmangshme dhe e nevojshme për të plotësuar kërkesat për shlyerjen në vlera të mëdha, mund të kompromentojë dhe riskojë pozicionin e investitorëve të përhershëm në Fond, shlyerja e kuotave mund të bëhet duke përdorur drejtpërdrejt aktive nga portofoli i Fondit.

E rëndësishme: Shlyerja me aktive mund të bëhet vetëm duke ruajtur proporcionalitetin e kuotave të cilat kërkohet të shlyhen me vlerën totale të aktiveve të Fondit.

Në rastet kur kërkesa për shlyerjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste zyrtare, dita e kërkesës së vlefshme për shitje do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

Asnjë kuotë nuk mund të shlyhet me çmim tjetër përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhrit për shitjen e kuotave.

2.8 Këmbimi i kuotave

Mbajtësit e kuotave të një fondi investimi mund t'i këmbajnë ato me kuota të një fondi tjetër investimi, në të njëjtën monedhë, të manaxhuar nga e njëjta shoqëri administruese, duke respektuar vlerat e shumës minimale të investimit dhe të shumës minimale të mbetur në fond.

Çdo investitor që dëshiron të këmbjë kuota në Fond, do të nënshkruajë një kërkesë për këmbim kuotash.

Për këmbimin e kuotave, numri i Kuotave të reja të blera do të përcaktohet duke iu referuar çmimeve përkatëse të Kuotave të Reja dhe Kuotave fillestare në momentin e vlerësimit.

Asnjë këmbim nuk do të kryhet gjatë periudhës kur e drejta e investitorëve për të kërkuar shlyerje të kuotave është pezulluar. Këmbimi i kuotave midis dy fondeve të investimit do të kryhet vetëm në një ditë pune kur të dy fondet kanë mundur të nxjerrin çmimet përkatëse të kuotave.

Efekti fiskal i këmbimit të kuotave është i njëjtë si në rastin e shitjes së tyre nga investitori (shlyerjes nga fondi).

2.9 Transferimi i kuotave të fondit

Shoqëria administruese “Abi Invest” do të lejojë transferimin e kuotave të investitorit në përputhje me parashikimet e nenit 117 të ligjit nr. 56/2020 si dhe aktet e tjera ligjore dhe rregullative.

2.10 Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave në një fond investimi

Shitja dhe shlyerja e kuotave në Fond, mund të pezullohet në rastet kur:

Së bashku, Shoqëria Administruese dhe Depozitari vlerësojnë se në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme në të cilat Fondi ndodhet si dhe për të mbrojtur interesat e mbajtësve ekzistues dhe potencial të kuotave, ka arsye të forta e të mirë-justifikuara për pezullim të shitjes dhe shlyerjes së tyre. Menjëherë pas marrjes së këtij vendimi, Shoqëria Administruese njofton AMF-në për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave. Gjatë shqyrtimit të njoftimit për pezullim, AMF merr në konsideratë nëse ka arsye për të besuar se pezullimi është i nevojshëm në interes të mbrojtjes së publikut ose mbajtësve të kuotave. Shoqëria Administruese publikon, në faqen zyrtare të internetit, në një gazetë të përditshme me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe me çdo mjet të besueshëm komunikimi, arsyet e pezullimit si dhe detaje dhe argumente të mjaftueshme në mënyrë që mbajtësit e kuotave të kenë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me këtë pezullim.

AMF nga ana e saj vlerëson apo konsideron se Fondi ndodhet në situatën ku ka shkaqe të forta dhe të mirë-justifikuara që të urdhërojë Shoqërinë Administruese dhe Depozitarin të pezullojë përkohësisht shitjet dhe shlyerjet, në mbrojtje të interesave të mbajtësve ekzistues ose potencial të kuotave. Shkaqet mund të jenë: a) rezultat papajtueshmërie ligjore e rregullatore nga inspektimet rutinë b) vlerësim i pasaktë i aktiveve c) vërtetohet rast mashtrimi apo neglizhence ç) verifikohet mungesë transparence me investitorin, mos-informim lidhur me Prospektin si dhe Informacionin Kryesor d) rrethana të caktuara cilësuese jashtë kontrollit të Fondit apo AMF-se dh) përballja e Fondit me një fluks shumë të lartë tërheqjesh detyron Fondin të likuidojë aktive, rast i cili vë seriozisht në risk investitorët e tjerë në sipërmarrje. AMF, publikon në faqen zyrtare të saj, arsyet dhe kohëzgjatjen e pezullimit, në rastet kur kjo e fundit dihet.

Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes merr fund sapo përfundojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, por jo më vonë se brenda njëzet ditëve pune nga pezullimi, me përjashtim të rastit kur AMF ka dhënë pëlqimin me shkrim për shtyrjen e këtij afati. Shoqëria Administruese informon AMF-në menjëherë me të rifilluar shitjen dhe shlyerjen dhe rifillimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave publikohet menjëherë nga Shoqëria Administruese në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të Shoqërisë Administruese.

Ri-aktivizimi i veprimtarisë tregtare të Fondit publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese, në një gazetë të përditshme me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe nëpërmjet një mjeti të besueshëm komunikimi menjëherë sapo të pushojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes. Në rast se rifillimi nuk është i mundur, AMF kërkon ndryshimin e këtyre fondeve në fonde me pjesëmarrje të mbyllur me ofertë publike ose që këto fonde të prishen dhe likuidohen, në përputhje me ligjin për SIK nr 56/2020 datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” seksioni 5 Neni 114 “Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes” si dhe të rregulloreve mbështetëse të tij.

2.11 Administrimi i pjesës së fitimit për mbajtësit e kuotave

Kuotat e Fondit janë kuota akumulimi, që do të thotë kuota për të cilat të ardhurat nga investimi ri-investohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave.

Fitimi nga investimi në fond reflektohet në rritjen e çmimit të kuotës.

Investitori mund ta tërheqë fitimin nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesshme të kuotave, në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtë prospekt.

2.12 Vlerësimi i aktiveve dhe çmimit të kuotës

Shoqëria administruese llogarit vlerën totale të aktiveve të Fondit, përcakton detyrimet e tij dhe llogarit vlerën neto të aktiveve të Fondit, si edhe vlerën neto të aktiveve për kuotë. Këto llogaritje bëhen në bazë ditore. Depozitari kontrollon dhe konfirmon llogaritjen e këtyre vlerave dhe është përgjegjës për saktësinë e tyre.

Metoda e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe në zbatim të tij, si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në metodologjinë « Për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondeve në USD » të përcaktuar nga shoqëria administruese dhe depozitari, portofoli i titujve për tregtim dhe/ose i vlefshëm për shitje do të rivlerësohet çdo ditë pune si në vijim

Për instrumentat financiare të tregtuara në një treg aktiv do të përdoret metoda e çmimit të tregut (*mark to market*). Vlera e instrumentit financiar në portofolin e fondit llogaritet duke shumëzuar çmimin e tregut më të fundit të disponueshëm në blerje (BID) të instrumentit përkatës përpara kohës në të cilën bëhet vlerësimi.

Në kushtet e një tregu jo-aktiv të titujve rivlerësimi bëhet në bazë të një metodologjie të dakortësuar me Depozitarin, e cila mbështetet në vlerën e drejtë të instrumentit financiar.

Kjo metodologji merr parasysh sa më poshte dhe aplikon teknikën përkatëse.

- çmimet e kuotuar për aktivet ose pasivet e ngjashme në tregjet aktive;
- çmimet e kuotuar për aktivet ose pasivet identike ose të ngjashme në tregjet që nuk janë aktive;
- inputet përveç çmimeve të kuotuar për aktivet ose pasivet, për shembull:
- normat e interesit dhe kurbat e yieldit të vëzhgueshme në intervalet e zakonshme të kuotuar
- volatiliteti i përlllogarit;
- Spreadi i kreditit;
- inputet që rrjedhin kryesisht nga ose janë konfirmuar nga të dhënat e tregut të vëzhgueshme sipas korrelacionit ose mënyrave të tjera.

Të ardhurat e interesit nga depozitat do të llogariten në bazë ditore, por pagesa do të bëhet në datën e maturimit të depozitës. Baza për llogaritjen e interesit është 360 ditë, dhe interesi fillon në datën e emetimit siç është rënë dakort në transaksion.

Çdo depozitë me datën e emetimit T dhe maturitet në datën N, do të gjenerojë interes nga data T deri në datën (N-1), por pagesa e interesit nga pala tjetër do të jetë në datën N.

Kuotat e fondeve të tjera të investimit do të rivlerësohen me vlerën neto të aktiveve për kuotë të fondit përkatës, sipas çmimit zyrtar të disponueshëm në ditën e vlerësimit.

Në rastin kur vlera neto e aktiveve për kuotë nuk është publikuar ose nuk është e disponueshme në ditën e vlerësimit, kuotat e mbajtura në fondet e tjera të investimit do të rivlerësohen me çmimin më të fundit të publikuar për atë fond.

Marrëveshjet e riblerjes vlerësohen nga dita e transaksionit në një mënyrë që titujt, objekt i ketij transaksioni, të vazhdojnë të vlerësohen në përputhje me rregullat e zbatueshme të llojit të titullit, ndërsa pasivet për fondet e mjeteve monetare të marra vlerësohen përmes llogaritjes së normës së interesit.

Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes vlerësohen nga dita e transaksionit, si depozitat në maturim, përmes llogaritjes ditore të interesit.

Transaksionet në instrumenta derivative do të vlerësohen sipas çmimit më të fundit të tregut, ose sipas përcaktimeve të rregulloreve përkatëse të AMF, në lidhje me vlerësimin e aktiveve.

Vlera e kuotës së Fondit në ditën e vlerësimit (T-1) përcaktohet duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të Fondit në lekë formuar deri në perfundim të ditës së punës ditë (T-1) me numrin e përgjithshëm të kuotave për atë ditë (T-1). Ky numër llogaritet duke i zbritur numrin e kuotave të shlyera në ditën e vlerësimit (T-1) dhe duke i shtuar numrin e kuotave që Fondi ka shitur në ditën e vlerësimit (T-1), numrit të përgjithshëm të kuotave në ditën para ditës së vlerësimit (T-2) $\text{Çmimi Final} = (\text{Vlera Totale e Aktiveve në ditën (T-1)-Detyrimet}) / \text{Nr. i kuotave në ditën T-1 pas rillogaritjeve}$

Gjatë ditës (T) kryhet vlerësimi i aktiveve neto të Fondit për kuotë për ditën (T-1).

Aktivet e ditës (T-1) do të vlerësohen deri në perfundim të operacioneve të asaj dite në orën 16:00.

Vlera neto e aktiveve për kuotë publikohet cdo ditë në faqen e internetit www.abinvest.al

2.13 Detyrimi i informimit të investitorëve

Shoqëria administruese ka detyrim t'i paraqesë rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme AMFsë raportime për veprimtarinë e saj të brendshme, si dhe për administrimin e Fondit në përputhje më afatet kohore të përcaktuara në Ligj dhe në aktet rregullative shoqëruese.

Pasqyrat Financiare vjetore dhe të ndërmjetme, prospekti, rregullat e Fondit dhe çdo informacion shtesë do të vihen në dispozicion të investitorëve pranë zyrave qendrore të shoqërisë administruese (Rruga e Kavajës 27/1, Tiranë) ose nëpërmjet postës elektronike pas një kërkesë me shkrim.

Prospekti i Fondit do të jetë i disponueshëm pranë çdo dege të Bankës Amerikane të Investimeve. Një kopje në letër e Propektit t'i dorëzohet investitorëve me kërkesë dhe pa pagesë

Ndërkohë, të gjitha informacionet e mësipërme, së bashku me çmimin e kuotës do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese.

Në mënyrë që të sigurohet informacion i nevojshëm dhe në kohë, investitori duhet të njoftojë shoqërinë administruese për çdo ndryshim në të dhënat e tij të kontaktit si: adresë, nr. tel. etj.

Çdo ndryshim thelbësor i prospektit, sipas legjislacionit në fuqi, i njoftohet të gjithë investitorëve nëpërmjet postës elektronike dhe publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese për një periudhë prej 60 ditësh gjatë së cilës investitorët kanë të drejtë të kërkojnë shitje të kuotave të tyre nga Fondi.

2.14 Procesi i mbylljes së fondit

2.14.1 Në cilat rrethana kryhet mbyllja

Shoqëria Administruese mund të iniciojë mbylljen e Fondit, kur krijohen rrethanat e parashikuara në ligjin nr.56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe në mënyrë të veçantë kur:

- Shoqëria administruese mbyll me vullnetin e saj aktivitetin
- Shoqëria administruese i nënshtrohet procedurave të falimentit dhe rrjedhimisht likuidimit si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve;
- AMF i ka hequr në mënyrë të përkohshme apo permanente licencën shoqërisë administruese;

2.14.2 Ekzekutuesi i procesit të mbylljes së Fondit

Mbyllja e Fondit të investimit si rregull kryhet nga Shoqëria Administruese, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- Në rast se kjo shoqëri është në proces falimenti, ose kur AMF i ka pezulluar përkohësisht ose ka revokuar në mënyrë permanente licencën e saj, atëherë mbyllja realizohet nga Depozitari i Fondit.
- Nëse Depozitari është në proces falimenti ose kur licenca e tij si Depozitar dhe/ose si Bankë është pezulluar përkohësisht apo është i/u është revokuar në mënyrë permanente, mbyllja e Fondit do të realizohet nga një likuidues fondi, i caktuar nga AMF.

2.14.3 Likuidimi dhe afatet për mbyllje të Fondit

Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve i paraqitet AMF-së, jo më pak se 3 muaj, përpara datës së propozuar të likuidimit së bashku me arsyet e kërkesës dhe një plan kohor për likuidimin.

Shoqëria harton pasqyrën e aftësisë paguese, e cila konfirmon që fondi është në gjendje të përmbushë të gjitha detyrimet brenda 12 muajve nga data e hartimit të kësaj pasqyre.

Pas dhënies së miratimit për likuidimin nga AMF, mbajtësit e kuotave njoftohen për këtë likuidim.

Në njoftim duhen përfshirë si më poshtë:

- arsyet e likuidimit;
- pasojat e mundshme për mbajtësit e kuotave;
- kostot përkatëse;
- pasqyrat e aftësisë paguese;
- datën e planifikuar të përfundimit të likuidimit vullnetar, përfshirë datën kur mbajtësit e kuotave do të kenë pagesën e vlerës së aksioneve ose kuotave;

2.15 Tarifat dhe Komisionet

a) Komisione/tarifa të njehershme (përpara ose pas investimit)

Komisioni/tarifa e hyrjes

Shoqëria administruese nuk do t'u ngarkojë mbajtësve të kuotave tarifë hyrëse

Komisioni/tarifa e daljes

Shoqëria administruese nuk do tu ngarkojë mbajtësve të kuotave tarifë dalëse

Pavarësisht sa më sipër investitoët mund të jenë subjekt i tarifave/komisioneve bankare për transferimin e fondeve drejt bankës depozitare apo për transferimin e fondeve nga banka depozitare në llogarine e tyre

b) Komisione/tarifa të mbajtura nga SIK gjatë periudhës së një viti

- Tarifa e Administrimit; e cila u ngarkohet mbajtësve të kuotave të fondit të investimit është deri në 2.00% e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe përlogaritët çdo ditë sipas formulës:
Tarifa vjetore e administrimit/365
- Tarifa dhe shpenzime të tjera :
 - tarifat dhe kostot, që i paguhen depozitarit që përfshijnë;
 - o tarifën e depozitarit
 - o tarifat e zakonshme të kujdestarisë për ruajtjen e instrumenteve financiare, si dhe tarifat e kujdestarisë që aplikohen nga nënkujdestari për instrumentet financiare jashtë Shqipërisë. Fondi do të ngarkohet dhe me shërbime të tjera të ofruara nga depozitari/kujdestari.
 - kostot e auditimit vjetor;
 - kostot dhe komisione për shit-blerje të aktiveve të fondit*;
 - tarifën e AMF, e ndryshueshme sipas vendimeve të AMF**;

Kostot totale qe paguhen nga asetet e fondit ne asnje rast nuk mund te tejkalojne 3,5% ne vit te vleres neto te aseteve te fondit

**Shoqëria Administruese do të zgjedhë në çdo rast, alternativën më të mirë të realizimit të transaksionit duke patur parasysh kostot e aplikuar.*

*** Tarifa e AMF është subjekt i ndryshimeve, të cilat janë jashtë kontrollit të shoqërisë administruese. Nëse kjo tarifë ndryshon atëherë do të aplikohet tarifa e ndryshuar sipas rregullores së AMF.*

c) Komisione/tarifa të tjera të cilat nuk do ti ngarkohen SIK

- kostot e mbajtjes së regjistrimit të kuotave, si dhe kostot e shpërndarjes së fitimeve;
- kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospekt dhe komunikimet e tjera me investitorin;
- të gjitha tarifat e parashikuara, që i paguhen AMF-së, për dhënien e licencës për Fondin;
- kostot e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifat postare për raportet gjashtëmujore dhe vjetore;
- kosto marketingu;

d) Kostot të cilat do të përballohen nga investitori sipas kërkesës

- Kostot e shërbimit të mbajtësve të kuotave si kostot e lëshimit të çertifikatave ose vërtetimeve mbi pronësinë e kuotave.
- Tarifa e transferimit i ngarkohet mbajtësit të kuotave që urdhëron transferimin.

e) Komisionet bankare të transferimit të fondeve

***Komisionet bankare të transferimit të fondeve nga shlyerja e kuotave paguhen tërësisht nga investitori. Shoqëria Administruese “ABI INVEST” nuk mban përgjegjësi për komisionet bankare që shoqërojnë investimin apo daljen nga fondi. Shoqëria Administruese do të bëjë përpjekje maksimale për uljen e kostove të transferimit të fondeve me palët e përfshira në proces.**

Shoqëria Administruese mund të ndryshojë tarifën e Fondit në përputhje me Ligjin nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij.

Çdo ndryshim tarifash do të reflektohet në ndryshime në prospektin e Fondit.

Rritja e tarifave, ose përfshirja e tarifave të reja të padeklaruara do të konsiderohet si ndryshim i rëndësishëm në prospekt. Të gjitha ndryshimet e rëndësishme në prospekt miratohen paraprakisht nga AMF dhe u njoftohen mbajtësve të kuotave në përputhje me paragrafin 2.13 të këtij prospekti.

Në rast të uljes së tarifave ky ndryshim aplikohet menjëherë dhe nuk konsiderohet si ndryshim i rëndësishëm

Tarifat ose shpenzimet e fondit pakësojnë vlerën neto të aktiveve të fondit dhe si rrjedhojë ndikojnë në çmimin e kuotës së fondit.

2.16 Trajtimi fiskal

Fondi, për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aktiveve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor. Të gjitha fitimet e realizuara nga investimi në fond, do të taten sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Investitori nëse realizon fitim në momentin e shitjes së kuotave të fondit, përballet me mbajtjen e tatimit në burim sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ndërkohë fondi investon në një shumëllojshmëri aktiveve dhe në disa tregje jashtë Republikës së Shqipërisë. Të ardhurat që rezultojnë nga investimet në këto tregje në formën e dividendëve, interesit, ose të ardhura të tjera gjithashtu dhe të ardhurat e realizuara nga shitblerja e instrumentave financiare mund të jenë subjekt i tatimit në burim, apo tatimeve të tjera të ngjashme të vendosura nga vendi ku këto të ardhura kanë origjinuar.

E rëndësishme: Shoqëria Administruese rekomandon çdo investitor, potencial apo ekzistues, të konsultohet me profesionistë të fushës fiskale për të konsideruar situatën e tij dhe efektet në rast të një investimi të mundshëm.

2.17 Viti Financiar

Viti financiar aktual për Fondin fillon më 18 11 2021 dhe përfundon më 31 12 2021. Për vitet pasardhëse, viti financiar i fondit do të jetë viti përkatës kalendarik, që fillon në Janar e përfundon në Dhjetor.

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Audituesi i jashtëm i fondit është **GRANT THORNTON Shpk**, shoqëri ndërkombëtare me profil auditimi, taksash dhe konsulencë financiare. Shoqëria e Auditimit GRANT THORNTON është e regjistruar në Regjistrin Publik të IEKA's, në Seksionin e Shoqërive të Auditimit me vendimin nr.165 datë 30.07.2009.

Shoqëria ka tre Auditues Ligjorë në rolin e ortakëve të Angazhimit: z. Kledian Kodra, z. Fatian Devija dhe znj. Manuela Nebo.

Administrator/Ofrues i shërbimit të auditimit:	Kledian Kodra Audituesi i Jashtëm
Adresa:	Rr. Sami Frashëri Kompleksi TID, Kati 1, Tiranë, Shqipëri
Tel:	+355 44 525 880
E-mail:	Contact@al.gt.com
Website:	www.granthornton.al

3. DEPOZITARI

Shoqëria Administruese ka lidhur një marrëveshje për kryerjen e shërbimit të depozitarit me **Bankën e Parë të Investimeve, Albania sh.a. me seli në adresën: Bul. “Dëshmoret e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë.**

Depozitari është licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e ndërmjetësimit për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit me Vendimin Nr. 13 datë 10.03.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe është licencuar nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes për të ushtruar veprimtarinë e depozitarit të fondeve të pensioneve vullnetare me vendimin nr 80 datë 30.08.2010 dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me vendimin nr 1, datë 13.12.2011.

Aktivet e Fondit, që përfshijnë llogaritë bankare si dhe aktive të llojeve të tjera, ruhen dhe mbahen nga Depozitari në një llogari të posaçme dhe nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për:

- kryerjen e transaksioneve për llogari të tij, ose
- të marrë ndonjë përfitim për vete a punonjësit e tij, ose
- qëllime të tjera, të ndryshme nga ato të përfitimit të mbajtësve të kuotave

Aktivet e Fondit që mbahen nga Depozitari gëzojnë të drejtën e veçimit dhe nuk përfshihen në aktivet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, që gjejnë zbatim sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve të të tretëve ndaj depozitarit.

Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të Fondit.

Krahas ruajtjes së aktiveve të Fondit, depozitari kryen, ndër të tjera, edhe veprimtaritë e mëposhtme:

- Garanton se shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave janë në përputhje me ligjin dhe aktin themelues të sipërmarrjes;
- Siguron se vlera neto e aktiveve të kuotave ose njërive të sipërmarrjes është llogaritur në përputhje me ligjin, aktet rregullative të miratuara nga AMF në bazë të ligjit dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

- Përmbush dhe zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese nëse nuk bien ndesh me ligjin, aktet rregullative të miratuara nga AMF në bazë të ligjit ose me aktin themelues të sipërmarrjes;
- Garanton kthimin e çdo shume përkatëse sipërmarrjes, brenda afateve kohore të përcaktuara lidhur me transaksionet që përfshijnë aktivet e sipërmarrjes;
- garanton se të ardhurat e sipërmarrjes përdoren në përputhje me ligjin dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;
- garanton që flukset monetare të sipërmarrjes monitorohen si duhet, në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga investitorët, ose në emër të investitorëve, me nënshkrimin e kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe se të gjitha mjetet monetare të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të Sipërmarrjes, Shoqërisë Administruese për llogari të Sipërmarrjes ose të Depozitarit për llogari të Sipërmarrjes; si edhe garanton dhe merr masat e nevojshme për të siguruar që fondet e sipërmarrjes SIK të depozituara pranë një banke qendrore, një banke në Republikën e Shqipërisë apo një banke të licencuar në një vend tjetër mbahen në një llogari ose disa llogari të identifikuar më vete nga çdo llogari e përdorur që i përkasin fondeve të Depozitarit apo fondeve dhe klientëve të tjerë të Depozitarit.
- emeton e anulon kuotat dhe paguan paratë e shlyerjes mbajtësve të kuotave, sipas udhëzimeve të Shoqërisë Administruese, kur këto udhëzime janë në përputhje me ligjin, me aktet rregullative të miratuara nga AMF në zbatim të ligjit dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;
- mban regjistrin e mbajtësve të kuotave dhe shërbimet e transferimit për fondet e investimeve me ofertë publike;
- i raporton AMF për çdo shkelje të ligjit dhe kontratës nga Shoqëria Administruese, në rast se kjo Shoqëri refuzon të pranojë kërkesën e tij për ndërprerjen e kësaj shkeljeje.

Në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore, Depozitari raporton çdo ditë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare përpara orës 12:00, parametrat kryesore të fondit që janë: vlera neto e aktiveve, numri i kuotave dhe çmimi i kuotës

3.2 Konflikti i Interesit në lidhje me depozitarin

Depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me Sipërmarrjen e Investimeve Kolektive me ofertë publike ose me Shoqërinë Administruese që administron Sipërmarrjen e Investimeve Kolektive me ofertë publike, të cilat mund të shkaktojnë konflikt interesi ndërmjet Sipërmarrjes së Investimeve Kolektive me ofertë publike, investitorëve të kësaj sipërmarrjeje, Shoqërisë Administruese dhe vetë Depozitarit, me përjashtim të rastit kur Depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të Depozitarit nga detyrat e tjera që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme dhe u bëhet i ditur investitorëve të Sipërmarrjes së Investimeve Kolektive me ofertë publike.

3.3 Përshkrimi i funksioneve të deleguara nga depozitari në lidhje me kujdestarinë e instrumentave financiare në monedhë të huaj

Banka Depozitare, për funksionet e kujdestarisë në lidhje me instrumentat financiare në monedhë të huaj do të përdorë shërbimin e nënkujdestarit që është [Raiffeisen Bank International].

Pavarësisht këtij delegimi Banka Depozitare do të mbajë përgjegjësi në lidhje me çdo dëmtim që u shkaktohet aktiveve të fondit si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të nënkujdestarit. Në kohën e përgatitjes së këtij prospekti nuk identifikohet asnjë konflikt interesi në lidhje me Bankën Depozitare dhe nënkujdestarin.

4. INFORMACION PLOTËSUES

Informacioni në këtë Prospekt bazohet në ligj dhe në praktikat me të mira. Çdo person që lexon këtë Prospekt, duhet të verifikojë pranë Shoqërisë Administruese “ABI Invest” ose në çdo degë të Bankës Amerikane të Investimeve se ky është versioni më i fundit dhe se nuk janë bërë rishikime apo ndryshime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dalë në qarkullim.

4.1 Konflikti i interesit

Shoqëria Administruese e SIK parandalon konfliktin e interesit që lind në lidhje me veprimtarinë e saj tregtare. Kjo Shoqëri ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm për të identifikuar dhe monitoruar konfliktin e interesit që lind në lidhje me administrimin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Ndër detyrat e Shoqërisë Administruese përfshihet shmangia e konfliktit të interesit në mënyrë që të garantojë që interesat e investitorëve në çdo lloj Sipërmarrje të Investimeve Kolektive të administruar nga Shoqëria e Administrimit të fondeve të kenë përparësi dhe të qëndrojnë mbi interesat e aksionarëve të Shoqërisë Administruese të fondeve, interesat e tyre dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të në zbatim të ligjit 56/2020 datë 30.04.2020 dhe të akteve në zbatim të tij.

Shoqëria administruese ka identifikuar disa elementë ku mund të krijohet konflikt interesi si në vijim:

4.1.1 Transaksionet me shoqërinë mëmë “Banka Amerikane e Investimeve”

Identifikimi i konfliktit: Shoqëria administruese do të kryejë transaksione në lidhje me blerjen apo shitjen e titujve me Bankën Amerikane të Investimeve. Kryerja e transaksioneve me Bankën Amerikane të Investimeve mund të krijojë konflikt interesi në përcaktimin e çmimit më të mirë në raport me bankat apo shoqëritë e tjera

Zgjidhja e konfliktit të interesit

Politikat dhe rregullat e ekzekutimit më të mirë, vendosin standartin për ekzekutimin e transaksioneve më shoqërinë mëmë, apo edhe me të gjitha shoqëritë e tjera që veprojnë në treg. Shoqëria administruese do të zgjedhë kundërpartinë me të cilën do të kryejë transaksionet bazuar në kriteret dhe ekskluzivisht në interesin më të mirë të investitorëve dhe integritetit të tregut. Shoqëria administruese do të japë urdhëra për blerje/shitje të instrumentave financiare vetëm pasi të sigurohet se egziston përputhshmëria duhur në raport me ligjin dhe rregulloret e nxjerra nga autoriteti që rregullojnë transaksionet me palët e lidhura.

4.1.2. Depozitat me Bankën Amerikane të Investimeve

Identifikimi i konfliktit: Shoqëria administruese rast pas rasti do të depozitojë likuiditetet e lira me Bankën Amerikane të Investimeve.

Zgjidhja e konfliktit: Shoqëria administruese do të përzgjedhë Bankën Amerikane të investimeve, në raport me Bankat e tjera në rastet kur kjo e fundit ofron kushtet më të mira në interesin më të mirë të investitorit. Shembull: Norma e interesit që ofron Banka Amerikane e Investimeve për depozitat është më e favorshme se ajo e bankave të tjera.

4.1.3 Disa anëtarë të këshillit të administrimit mbajnë pozicione drejtuese në shoqërinë mëmë “Banka Amerikane e Investimeve”

Identifikimi i konfliktit: Disa anëtarë të këshillit të administrimit që mbajnë pozicione drejtuese në shoqërinë mëmë mund të kenë konflikt në raport me pozicionin e tyre me shoqërinë mëmë.

Zgjidhja e konfliktit: Anëtarët e këshillit të administrimit, të cilët mbajnë pozicione drejtuese në shoqërinë mëmë janë njëloj përgjegjës për të gjitha veprimet dhe mosveprimet e tyre në përputhje me ligjin dhe rregulloret e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe do të ushtrojnë vëmendjen e duhur për të vepruar në cdo rast në interesin më të mirë të investitorëve të fondit.

4.2 Kujdesi

Administrimi i portofolit të fondit kryhet nëpërmjet një gjykimi të matur e të kujdesshëm, i parë në të njëjtin këndvështrim të atij të administrimit të financave dhe investimeve personale të vetë personelit kyç i cili ka në ngarkim këtë funksion. Përpjekje maksimale e transparente kryhen për të maksimizuar ruajtjen e kapitalit të investitorëve me aplikimin e masave prudenciale të riskut pa prapaskena arbitrazhi e spekulimi, por me synim përfitimi të pastër nga investimi.

4.3 “FATCA” dhe “CRS/Shkëmbimi Automatik i Informacionit të Llogarive Financiare”

Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare në zbatim të Ligjit nr.4, datë 30.1.2020

ABI Invest sh.a, si Shoqëri Administruese e Fondit të Investimit “ABI FLEX USD” është plotësisht e angazhuar për të përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara nga Ligji Nr. 4/2020 datë 30.01.2020 për “Shkëmbimin Automatik të Informacionit për Llogaritë Financiare” dhe Aktin për Përputhshmërinë Tatimore të Llogarive të Huaja (“FATCA”). Gjithashtu, shoqëria “Abi Invest” Sh.a, në kuadër të përpjekjeve kombëtare dhe globale për të luftuar praktikën e fshehjes së të ardhurave nëpërmjet mbajtjes dhe menaxhimit të investimeve në institucione financiare jashtë vendeve të rezidencës, do të bashkëpunojë pa rezerva me të gjithë autoritetet tatimore vendase dhe të huaja.

Për të qenë në përputhje me legjislacionin fiskal të kërkuar nga SHBA, fondi do të regjistrohet në Agjencinë Kombëtare të të Ardhurave (IRS), konkretisht në FATCA (Foreign Account Tax Compliance Act) me status “Institucion Financiar i Huaj (FFI) Pjesëmarrës”. Bazuar në kërkesën e Investitorëve, Shoqëria Administruese do të njoftojë këta të fundit për numrin Unik GIIN për qëllime raportimi në FATCA.

4.4 ANKESAT

Çdo ankesë e cila mund të lindë si pasojë e bashkëpunimit mes investitorit dhe Shoqërisë Administruese mund të dërgohet me shkrim në adresën e Shoqërisë Administruese “ABI Invest”, Rruga e Kavajës 27/1, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria Administruese angazhohet për shqyrtim të të gjitha ankesave dhe kthim përgjigjeje brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes në dorëzim të tyre.

4.5 Ekzekutimi më i mirë i vendimeve të tregtimit

Shoqëria administruese zbaton procedurat e ekzekutimit më të mirë të vendimeve të tregtimit duke marrë të gjithë hapat e arsyeshëm përpara ekzekutimit në mënyrë që procesi i ekzekutimit të japë rezultatet më të mira të mundshme në interes të investitorëve.

Faktorët e ekzekutimit më të mirë që do të merren në konsideratë janë si në vijim

- Çmimi më i mirë në treg në raport me madhësinë e urdhërit
- Kosto më e ulët
- Shpejtësia e transaksionit
- Probabiliteti i ekzekutimit
- Shlyerja dhe klerimi

4.6 Vendet e ekzekutimit

Vendet e ekzekutimit që mundësojnë ekzekutimin më të mirë për instrumentat financiare të parashikuara në politikën e investimit të këtij fondi janë

- Tregjet e rregulluara
- Tregjet mbi banak (OTC)

Shoqëria administruese do të përzgjedhë vendin e tregtimit duke marrë parasysh të gjitha elementët e ekzekutimit më të mirë të përmendur në pikën 4.5, duke i dhënë prioritet atyre elementëve të cilët japin rezultatin më të mirë në interes të investitorit

4.7 Profili i investitorit tipik të cilit i drejtohet fondi

Investitorët potencialë të cilët mund të afrohen për të investuar në fond janë pa përjashtim çdo individ, person fizik apo juridik, me kushtin që të jenë informuar thellësisht për kushtet dhe karakteristikat e investimeve kolektive.

Ky fond investimesh është i përshtatshëm për investitorët të cilët kërkojnë një nivel më të lartë rreziku dhe përfitimi duke u ekspozuar ndaj një shumëllojshmërie të klasave të aktiveve të cilat janë përcaktuar në politikën e investimit të fondit. Ekspozimi ndaj këtyre klasave aktivesh do të mundësojë në të njëjtën kohë diversifikimin e aktiveve të fondit dhe njëkohësisht të ofrojë mundësi për rritje afatgjatë.

Investitorët duhet të jenë të përgatitur që në lidhje me këtë fond investimi i tyre mund të pësojë humbje, duke përfshirë humbje të larta, të cilat do të jenë në varësi të lëvizjeve të çmimeve të aktiveve në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Në mënyrë që të jenë në gjendje të vlerësojnë rreziqet dhe mundësitë që ofron investimi në këtë fond investitorët këshillohen të konsultohen me ekspertët e fushës. Minimumi i rekomanduar i investimit është 10 vjet.

ANEKS I: RREGULLAT E FONDIT TE INVESTIMIT “ABI FLEX USD”

Neni 1: Rregullat e Fondit

Rregullat e Fondit rregullojnë kushtet e veprimtarisë së Fondit të Investimit “ABI FLEX USD” (në vijim referuar si “Fondi”, një Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, i themeluar nga “ABI Invest” - Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, si dhe marrëdhëniet ligjore ndërmjet “ABI Invest” sh.a

(në vijim referuar si “Shoqëria Administruese”) si dhe kuota-mbajtësve në Fond (në vijim referuar si “Investitorët”).

Rregullat e fondit nuk përmbajnë detyrimisht të gjithë informacionin dhe të dhënat të paraqitura në prospekt. Investitorët këshillohen të studiojnë të gjithë përmbajtjen e prospektit.

Neni 2: Veprimtaria e Fondit

Objekti i veprimtarisë së Fondit është akumulimi i aseteve monetare ose të klasifikuara të ngjashme me to nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, të cilat investohen në asete sipas përcaktimeve në këtë Prospekt duke ndjekur gjithashtu parime të diversifikimit të risqeve apo portofolit. Investitorët kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, si dhe të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre, sipas dispozitave të Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” (në vijim “Ligji”) si dhe Prospektit.

Neni 3: Krijimi i Fondit

Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe fillon veprimtarinë e tij më datë 18.10.2021.

Prospekti i Fondit është miratuar nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese “ABI Invest” më datë 05.03.2021, si dhe është miratuar nga AMF me vendimin nr. 110, datë 30.06.2021.

Neni 4: Pjesëmarrja

Çdo person mund të blejë kuota në Fond, duke hyrë në një marrëdhënie ligjore/kontraktuale, me Shoqërinë Administruese.

Shoqëria administruese përlogarit dhe publikon çdo ditë vlerën e kuotës. Llogaritja e vlerës neto të aseteve dhe çmimit të kuotës kontrollohet dhe verifikohet nga Depozitari, institucion/funksion përgjegjës për saktësinë e këtyre llogaritjeve.

Çdo investitor në momentin e blerjes së kuotave nëshkruan një kontratë dhe në këtë mënyrë konfirmon se është njohur dhe ka rënë dakord me përcaktimet në Prospekt si dhe me Rregullat e Fondit.

Neni 5: Investimet

Objekti i investimit të Fondit është të maksimizojë përfitueshmërinë/kthimin për investitorët duke mbajtur në vëmendje gjithashtu të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Kthimi përbëhet nga të ardhurat nga interesat e investimeve, fitimi apo humbja nga rivlerësimi i kapitalit duke përfshirë dhe të ardhurat nga aktiviteti i tregtimit të titujve.

Fondi synon të investojë:

- 55% të aktiveve në obligacione, të emëtuara nga shtetet anëtare të BE, vendet e tregjeve në zhvillim (emerging markets), Republika e Shqipërisë apo vendet e rajonit, dhe/ose obligacione të emëtuara nga shoqëri tregtare të pranuar për tregtim në tregjet e rregulluara të vendeve të zhvilluara si ,BE, SHBA, Zvicër, Britaninë e Madhe, Kanada, Australi apo vendet e paqësorit ose në tregjet e rregulluara të Republikës së Shqipërisë, vendeve të rajonit apo vendeve në zhvillim (emerging markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine apo Azi, apo kuota ose aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në obligacione.
- 30% në aksione të shoqërive tregtare, kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në aksione, pjesë përbërëse e bursave të vendeve të zhvilluara të tilla si BE, SHBA, Zvicra, Kanadaja, Britania e Madhe, Australia apo vendet e paqësorit dhe/apo vendeve në zhvillim (Emerging Markets) në Europë, Lindjen e Mesme, Afrikë, Amerikën Latine ose Azi
- 5% në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në tregun e metaleve të çmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo të tjera
- 10% të aktiveve në depozita, llogari rrjedhëse, marrëveshje të anasjellta riblerje, apo huadhënie titujsh

Fondi mund të përdorë instrumentët financiarë derivative për qëllime të mbrotjes nga risku Pavarësisht nga sa më sipër fondi mund të devijojë nga shpërndarja e synuar duke u bazuar në gjykimin e menaxherëve të fondit. Nuk ka kufizim në lidhje me masën e këtij devijimi, nga shpërndarja e synuar.

Neni 6: Huamarrja

Përçindja maksimale e vlerës së Sipërmarrjes së Investimeve Kolektive me ofertë publike, që mund të merret hua është 10%, lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, që është fond me pjesëmarrje të hapur, në zbatim të ligjit 56/2020 dt 30.04.2020. “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Neni 7: Të drejtat dhe përgjegjësitë e investitorëve në Fond

Investitorët në Fond kanë të drejtat e mëposhtme:

- Të kenë pronësinë e kuotave dhe të pajisen me çertifikatën e pronësisë (sipas kërkesës);
- Të materializojnë fitimin e tyre nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesshme të kuotave;
- Të kontribuojnë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
- Të informohen periodikisht (raporte periodike sipas kërkesës);
- Të kërkojnë shitjen e pjesshme apo të plotë të kuotave në çdo kohë;
- Të drejtën e transferimit
- Të drejtën e këmbimit të kuotave të fondit me ato të një fondi tjetër të administruar nga e njëjta shoqëri administruese
- Aktivitet e tyre të jenë objekt i së drejtës së veçimit në rast falimenti të Shoqërisë Administruese;
- Investitorët kanë përgjegjësi të limituar për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në Fond.

Neni 8: Shlyerja e kuotave

Investitorët kanë të drejtë të kërkojnë në çdo moment shitjen e kuotave që kanë në pronësi të tyre nëpërmjet një kërkesë për shitje.

Shlyerja e kuotave në Fond bëhet nga Shoqëria Administruese jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Neni 9: Depozitari

Shoqëria administruese ka lidhur një kontratë me First Investment Bank, Albania sh.a., me seli në adresën Bul. “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë, e cila në përputhje me ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, do të ofrojë shërbimet e depozitarit për aktivet e Fondit. Pjesë përbërëse e rregullave të fondit është Deklarata e Kujdestarisë së Depozitarit.

Neni 10: Kontabiliteti

Shoqëria Administruese përpilon pasqyrat dhe raporte të tjera financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standartet e pranuar të SNRF.

Neni 11: Kontrolli dhe Auditimi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese kontrollohen nga ekspertët kontabël të autorizuar të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 12: Ruajtja e Konfidencialitetit

Personat kyç, personeli kyç dhe punonjësit e Shoqërisë Administruese të fondeve trajtojnë si konfidencial dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo informacion mbi pjesëmarrësit që mund të marrin dijeni për shkak të detyrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me akte ligjore dhe nënligjore. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe për personat që kryejnë detyra në emër të Shoqërisë Administruese të fondeve, përfshirë subjektet të cilave u është deleguar në zbatim të nenit 25, të këtij ligji, si dhe punonjësve të tyre. Dispozitat e kësaj pike nuk zbatohen për rastet e mëposhtme:

- kur mbajtësi i aksionit ose kuotës në fond shprehet dakord me shkrim për përhapjen e disa të dhënave të caktuara konfidenciale;
- kur të dhënat i kërkon AMF, gjykata ose një autoritet tjetër rregullator në funksion të një procedure të kryer brenda kompetencave të tij dhe për këtë i jep subjektit kërkesë me shkrim për informacionin;
- kur të dhënat i bëhen të ditura shoqërisë mëmë lidhur me mbikëqyrjen, në përputhje me këtë ligj ose në përputhje me ligjin që rregullon grupimet financiare.

Sa më sipër në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr 56/2020 dt 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Neni 13: Shoqëria Administruese dhe detyrimet

Shoqëria administruese gjatë administrimit të fondit ka detyrimet e mëposhtme:

- Të menaxhojë Fondin në linjë me objektivat e investimit të parashikuara në prospekt;
- Të krijojë dhe të mirëmbajë regjistrin e kuotave për çdo investitor;
- Të depozitojë në një depozitar të vetëm çdo veprim me asetet, në emër dhe për llogari të Fondit;
- Të ndjekë procedurat e përcaktuara në Ligj dhe prospekt lidhur me proceset e shitjes së kuotave të Fondit;
- Të shlyejë në kohën dhe në mënyrën e duhur të gjitha detyrimet monetare;
- Të informojë periodikisht investitorët, sipas parashikimeve në prospekt;
- Të garantojë konfidencialitet maksimal të të dhënave nën administrim;
- Të verë në dispozicion të investitorëve pa pagesë kopje fizike të Prospektit para lidhjes së kontratës për blerjen e kuotave
- Të publikojë kopje elektronike të Prospektit në faqen e saj të internetit www.abinvest.al
- Të publikojë mimin e kuotës çdo ditë në faqen e internetit www.abinvest.al

Neni 14: Tarifat e Shoqërisë Administruese

Shoqëria Administruese aplikon një tarifë administrimi për të gjithë investitorët në fond, e cila do të jetë deri në 2.00% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit;

Shoqëria Administruese nuk aplikon tarifë hyrëse dhe dalëse nga fondi;

Shoqëria administruese do të ngarkojë fondit: të gjitha tarifatat dhe kostot që i paguhen depozitarit, kostot e auditimit vjetor; tarifën e AMF, kostot dhe komisionet për shitblerjen e aktiveve të fondit.

Tarifa totale që do të ngarkohet fondit nga shoqëria administruese nuk do të tejkalojë 3.50% në vit të vlerës neto të aktiveve të fondit.

Shpenzimet e mëposhtme do të ngarkohen investitorit që kryen kërkesën për të përfituar shërbimin : kostot e lëshimit të certikatave të transaksionit ose vërtetime mbi pronësinë e kuotave, tarifa për transferimin

Çdo rritje e tarifave, apo aplikimi i tarifave të tjera shtesë që nuk ishin parashikuar që do të aplikohet nga Shoqëria Administruese, do të njoftohet investitorëve të paktën 2 muaj përpara, sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Prospektin e Fondit.

Neni 15: Ri-shikimet dhe miratimet e Rregullave të Fondit

Rregullat e Fondit miratohen nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese.

Rregullat e Fondit i bashkëngjiten prospektit dhe bëjnë pjesë integrale të tij.

Ndryshimet dhe shtesat në rregullat e Fondit, do të miratohen paraprakisht nga Këshilli i Administrimit si dhe do të marrin miratimin e AMF-së në përputhje me dispozitat e Ligjit.

Neni 16: Monedha

Monedha bazë e Fondit është USD.

Neni 17: Të tjera

Mosmarrëveshjet cilat mund të lindin si rezultat i zbatimit apo interpretimi i këtyre rregullave, do të zgjidhen në bazë të legjislacionit shqiptar.

Rregullat e Fondit do të hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Prospekti u miratua nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 111 datë 30.06.2021

ANEKSI 2: DEKLARATA E KUJDESTARISË

Bazuar në Ligjin nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kollective” në cilësinë e Depozitarit të Fondit të Investimit “ABI FLEX USD”,

Deklaroj:

Pasuria e sipërmarrjes së investimeve kolektive, do të ruhet nga Depozitari për llogari të investitorëve, duke respektuar parimin e barazisë, në përputhje me numrin e kuotave që zotëron çdo investitor, ose në rastin kur ekzistojnë njëkohësisht si kuota të ardhurash, ashtu edhe kuota akumulimi, në përputhje me pjesën individuale në pasurinë e sipërmarrjes, e llogaritur në bazë të kuotave të zotëruara nga çdo investitor;

Shumat, që ndodhen në llogarinë e parave për t’u shpërndarë, mbahen nga Depozitari vetëm për qëllime shpërndarjeje.

Monedha bazë e Fondit është USD.

Viti Financiar i Fondit për vitin 2021, fillon më datë 18.11.2021 dhe përfundon më datë 31.12.2021. Për vitet pasardhëse, viti financiar i fondit do të jetë viti përkatës kalendarik (Janar - Dhjetor)

Depozitari: BANKA E PARË E INVESTIMEVE-ALBANIA SH.A.

Bozhidar Todorov
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

Elma Lloja
Drejtor Ekzekutiv

Tiranë, Tetor 2021

ANEKSI 3: DEKLARATA E INVESTITORIT

Datë:

Unë, i/e nënshkruari/a _____ deklaroj se i kam lexuar dhe kuptuar kushtet e ofertës dhe risqet e përfshira.

Investitori

(Emer, Mbiemër, Firmë)